



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar
Tiranë, më 26.04.2019

RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN
“PËR SHËRBIMIN PËRMBARIMOR GJYQËSOR PRIVAT”

I. Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjet e datave 15.4.2019, 23.04.2014, 24.04.2019 dhe 26.04.2019 mori në shqyrtim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, i ndryshuar”, propozim i deputetëve Edmond Leka dhe Jurgis Çyrbja.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Alket Hyseni.

Projektligji është paraqitur nga grupi i ekspertëve në Komisionin e Posaçëm, në mbledhjen e datës 16.12.2016, si pjesë e paketës së 27 projektligjeve të hartuara në kuadrin e reformës në drejtësi, pjesë e shtyllës së profesioneve të lira. Bazuar në vendimin 97/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, ky projektligj i ka kaluar për shqyrtim Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Në mbledhjet e Komisionit për të diskutuar dhe paraqitur propozime për projektligjin ishin të pranishëm: znj. Katrin Treska, Drejtoreshë e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë, z. Edvin Kukunja, Këshilltar i Ministrit të Drejtësisë dhe përfaqësues të kësaj ministrie; z. Idlir Peci ekspert i Nivelit të Lartë pranë misionit EURALIUS dhe z. Tedi Dobi ekspert vendas pranë këtij misioni; si dhe z. Tedi Malaveci, Kryetar i Dhomës së Përmbaruesve Gjyqësor Privat, z. Zef Macaj nënkryetar i Dhomës dhe z. Alban Ruli Kryetar i Këshillit Drejtues të Dhomës.

II. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozim deputeti, sipas përcaktimeve të neneve 78, 81, pika 1 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Nga analiza e nenit 81, pika 2, të Kushtetutës dhe përmbajtjes konkrete të këtij projektligji rezulton se fusha që rregullon ky projektligj nuk përfshihet në çështjet që trajton kjo dispozitë kushtetuese, e për pasojë miratimi i këtij projektligji i nënshtrohet rregullit të përgjithshëm për sa i përket shumicës.

II. QËLLIMI DHE RISITË E PROJEKTLIGJIT

Projektligji *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, i ndryshuar* ka qenë një nga projektligjet e hartuara në kuadrin e Reformës në Sistemin e Drejtësisë. Ky projektligj ka për qëllim ridimensionimin e shërbimit përmbarimor gjyqësor privat, në terma të rritjes së efikasitetit për proceset e ekzekutimit, besueshmërisë publike si dhe rritjes së profesionalizmit, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies në ushtrimin e këtij profesioni.

Analiza e Sistemit të Drejtësisë e miratuar nga Komisioni i Posaçëm “Për reformën në Sistemin e Drejtësisë” me vendimin nr.14 dt.30.7.2015 ka evidentuar një sërë problematikash sa i takon ofrimin të shërbimit përmbarimor, të cilat përmbledhen si më poshtë:

- a. zgjatje të pajustificuara në ekzekutimin e titujve ekzekutivë;
- b. mungesë transparencë dhe përkushtimi në ushtrimin e detyrave, si dhe vonesa në ekzekutim;
- c. paqartësi ligjore në rastet kur një përmbarues gjyqësor privat është subjekt i pezullimit të përkohshëm të veprimtarisë, kur kjo veprimtari mund të rifillojë apo kur bëhet çregjistrimi e ri-regjistrimi përkatës;
- d. mungesa e një programi trajnimi vazhdues të përmbaruesve gjyqësor privat;
- e. nivel të ulët të edukimit ligjor për përmbaruesit e cila ka ndikuar edhe në performancën e tyre në drejtim të profesionalizmit;
- f. licencimi i përmbaruesve nuk lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë e tyre profesionale dhe me trajnimin e tyre të posaçëm të shoqëruar me mundësi për t'u trajnuar para licencimit dhe me detyrimin që të trajnohen pas licencimit;
- g. problematik paraqitet parashikimi i ligji aktual, i cili përjashton nga detyrimi për të dhënë provimin e kualifikimit personat, që në datën 30.12.2011 kanë qenë përmbarues gjyqësorë në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor.

Në tërësinë e tyre, gjetjet dhe problematikat e evidentuara në Analizën e Sistemit të Drejtësisë në lidhje me shërbimin përmbarimor, identifikojnë probleme, që kërkojnë marrjen e

masave konkrete për zgjidhjen e tyre nëpërmjet reformimit të sistemit dhe përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore në ofrimin e këtij shërbimi për qytetarët.

Për adresimin e problematikave dhe gjetjeve të evidentuar nga Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Strategjinë e Reformës në Sistemin e Drejtësisë dhe Planin e saj të Veprimit është parashikuar si objektiv “garantimi i ekzekutimit efektiv të titujve ekzekutiv duke përmirësuar rregullat procedurale dhe nivelin e shërbimit të përmbauesve, si dhe duke rritur profesionalizmin, përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien në ushtrimin e këtij profesioni” nëpërmjet këtyre masave:

- hartimin e kuadrit ligjor në përputhje me standardet e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian;
- parashikimin në ligj të dispozitave për trajnimet e detyrueshme fillestare dhe të vazhdueshme të përmbauesve duke përcaktuar një minimum kërkesash të trajnimit profesional;
- parashikimin në ligj të dispozitave për krijimin e mekanizmave strikte të kontrollit gjatë trajnimit;
- krijimin e një strukture për trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm;
- parashikimin e trajnimit të detyrueshëm vazhdues duke përfshirë një sistem të krediteteve të detyrueshëm profesional;
- hartimin e dispozitave ligjore për trajnimin vazhdues për rregullat e etikës dhe standardeve profesionale;
- riorganizimin e komisionit të ngarkuar me dhënien e licencave për përmbauesit privat, me qëllim përmirësimin e transparencës dhe objektivitetit në provimin licencues dhe formimin profesional të përmbauesve të rinj të licencuar;
- përmirësimin e kuadrit ligjor dhe organizativ të ushtrimit të profesionit të përmbauesit, duke fuqizuar rolin rregullator të Dhomës së Përmbauesve Gjyqësor Privatë;
- përcaktimin e një mekanizmi të qartë ligjor për numrin e përmbauesve privatë bazuar në një vlerësim të rregullave ekzistuese për numrin e licensave dhe praktikave më të mira europiane;
- hartimin e dispozitave ligjore për krijimin e një sistemi monitorimi dhe kontrolli efektiv për vlerësimin e ekzekutimit në aspektin e legjitimitetit etj.

Objekt i këtij projektligji janë hartimi i një sërë dispozitash ligjore me qëllim rritjen e cilësisë së procesit të ekzekutimit nëpërmjet:

- rritjes së mbështetjes ligjore të përmbauesit gjyqësor privat gjatë një procedure ekzekutimi;
- rritjes së performancës profesionale të përmbauesit gjyqësor privat; si edhe
- përcaktimit të një kuadri monitorues efektiv që rrit transparencën dhe llogaridhënien ligjore.

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara në Analizën e Sistemit të Drejtësisë dhe përmbushjen e objektivave të parashikuara në strategjinë dhe planin e veprimit, draft-ligji i propozuar si nismë deputësh paraqet risitë e mëposhtme:

- a. Harmonizimi i këtij projektligji me paketën e ligjeve të reformës në sistemin e drejtësisë, përkatësisht me ligjin nr. 38/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116/1996 “Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe reflektimi në këtë projektligji i detyrimeve të parashikuara nga ky akt ligjor.
- b. Projektligji ka sanksionuar mundësinë e ofrimit të shërbimit përbarimor nëpërmjet një subjekti tregtar ku ortakët/aksionarët dhe/ose administratorët duhet të kenë cilësinë e përbaruesit gjyqësor. Kjo garanci ligjore disiplinon mënyrën e ofrimit të shërbimit përbarimor prej subjekteve tregtare.
- c. Një risi e këtij projektligji është edhe parashikimi në një kre të posaçëm i procesit të trajnimit fillestar dhe vazhdues të përbaruesve gjyqësor privat, sipas standardeve ndërkombëtare, duke synuar formim cilësor të kandidatëve për përbarues gjyqësor privatë dhe përbarues gjyqësor privat të kualifikuar.
- d. Për ofrimin e një shërbimi përbarimor të paanshëm janë ndryshuar dispozitat lidhur me papajtueshmërinë me detyrat e përbaruesve gjyqësorë privatë, duke saktësuar rastet kur ky funksion është në papajtueshmëri me detyra të tjera.
- e. Projektligji propozon forcimin e kushteve për t’u licencuar si përbarues gjyqësor privat, të cilat synojnë të afrojnë kandidatë cilësorë dhe me integritet moral dhe profesional, ku i është dhënë rëndësi praktikës profesionale si dhe provimit të kualifikimit për përbarues gjyqësorë.
- f. Një nga çështjet më të rëndësishme të këtij projektligji, është edhe sanksionimi ligjor i llogarisë bankare të përbaruesit gjyqësor, si dhe një mekanizëm i cilit pritët të garantojë përgjegjësinë ligjore profesionale të përbaruesit gjyqësor dhe transparencën në veprimtarinë përbarimore.
- g. Në kuadër të rritjes së profesionalizmit, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies në ushtrimin e profesionit të përbaruesve gjyqësorë si dhe garantimit të interesit publik, projektligji parashikon në një Kre të veçantë kontrollin e veprimtarisë së përbaruesve gjyqësorë privat nga Ministria e Drejtësisë dhe mbikëqyrjen nga Dhoma për çështjet të lidhura me respektimin e standarteve profesionale dhe Kodit Etik.
- h. Rikonceptim i Kreut që trajton procedimin disiplinor sipas standardeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe riformatim të përbërjes së Komisionit Disiplinor me qëllim garantimin e pavarësisë dhe paanësisë në vendimmarrjen lidhur me masat disiplinore.

IV. STANDARTET NDËRKOMBËTARE

Standartet ndërkombëtare në fushën e shërbimit të përmbarimit gjyqësor janë përcaktuara në një sërë aktesh të organizatave ndërkombëtare ku mund të përmendim:

- Rekomandimin Nr.17, datë 9 shtator 2003, të Këshillit të Evropës “Për Ekzekutimin Përmbarimor”.
- Udhëzuesin Nr. 11, datë 17 Dhjetor 2009, të Komisionit European për Efiçencën në sistemin e Drejtësisë (CEPEJ) “Mbi implementimin e rekomandimit të Këshillit të Evropës për ekzekutimin”.
- “Kodin Global i Ekzekutimit të Detyruar”.

Sipas Rekomandimit 17/2003 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në mënyrë që procedurat e përmbarimit të jenë sa më efikase duhet që:

- procedurat përmbarimore të përcaktohen dhe mbështeten nga një kornizë e qartë ligjore, ku përcaktohen kompetencat, të drejtat dhe përgjegjësitë e palëve dhe të palëve të treta;
- legjislacioni duhet të parashikojë sigurinë ligjore dhe transparencën e procesit;
- palët duhet të kenë detyrë të bashkëpunojnë në mënyrën e duhur në procesin e përmbarimit dhe në veçanti, në çështjet e së drejtës familjare, autoritetet relevante duhet të lehtësojnë këtë bashkëpunim;
- shtetet duhet të krijojnë një mekanizëm për të parandaluar keqpërdorimin e procesit të përmbarimit nga secila palë e cila nuk duhet të konsiderohet si një rishqyrtim i çështjes;
- përmbaruesi gjyqësor duhet të jetë i paanshëm dhe kompetent në ushtrimin e detyrave të tij, duke vepruar në çdo kohë sipas parimeve më të larta profesionale dhe etike;
- gjatë procesit të përmbarimit duhet të sigurohet balanca e duhur ndërmjet interesave të kreditorëve dhe të debitorëve duke pasur parasysh, në veçanti, dispozitat e neneve 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

V. PROÇESI I HARTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK TË NISMËS LIGJORE

Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, të ndryshuar është pjesë e paketës së dytë të projektligjeve për reformën në sistemin e drejtësisë, shtylla e profesioneve të lira.

Projektligji është paraqitur nga grupi i ekspertëve në Komisionin e Posaçëm, në mbledhjen e datës 16.12.2016, si pjesë e paketës së 27 projektligjeve të hartuara në kuadrin e reformës në drejtësi. Bazuar në vendimin nr. 97/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, ky projektligj i ka kaluar për shqyrtim Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Në funksion të transparencës dhe gjithëpërfshirjes, projektligji i depozituar si nismë deputeti, gjatë periudhës Janar-Mars 2017 është përcjellë nga Komisioni i Ligjeve për konsultim

pranë ministrive të linjës, institucioneve të fushës, grupeve të interesit, organizatave të shoqërisë civile etj.

Në datën 28.02.2017 është organizuar një tryezë konsultimi, për këtë projektligj. Në këtë tryezë morën pjesë: përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësor Privat, përmbaues gjyqësor privat, përfaqësues të Shoqatës së Bankave, përfaqësues të Bankës së Shqipërisë; përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile etj.

Me qëllim vlerësimin/reflektimin e sugjerimeve/komenteve dhe propozimeve të paraqitura, ka vijuar diskutimi i projektligjeve në grupet e punës, proces që është ndjekur për çdo projektligj të paketës së dytë të reformës në sistemin e drejtësisë.

Gjatë kësaj tryeze, por edhe gjatë procesit të konsultimit në vazhdim, përveç sugjerimeve për ndryshime të mëtejshme, që kishin të bënin edhe me përmbajtjen, doli në pah nevoja për një qasje më të plotë me standartet ndërkombëtare dhe praktikën më të mira në këtë fushë.

Projektligji *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbauesve gjyqësor privat”*, i ndryshuar, është ripunuar me një grup pune të përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, nën asistencën dhe ekspertizën e ekspertëve të misionit EURALIUS dhe nën drejtimin e relatorit të caktuar nga Komisioni përgjegjës për çështjet ligjore.

Grupi i punës pas takimeve dhe diskutimeve konkludoi në një draft, i cili synonte të adresojë jo vetëm mangësitë e evidentuara në Analizën e Sistemit të Drejtësisë, por edhe të adresojë problematikat e evidentuara gjatë procesit të marrjes së mendimeve dhe konsultimit të projektligjit.

Ky draft u dërgua për mendim në datën 04.03.2019 nga Komisioni i Ligjeve në adresë të: Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësor Privat, secilit përmbaues gjyqësor referuar regjistrin të publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, Bankës së Shqipërisë, Shoqatës së Bankave, Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbaimit Gjyqësor Shtetëror. Projektligji i është dërguar njëkohësisht për mendim Këshillit të Ministrave.

Në përfundim të afatit të lënë në dispozicion për paraqitjen e komenteve dhe sugjerimeve Komisioni i Ligjeve në funksion të gjithëpërfshirjes dhe transparencës, e cila tashmë është një praktikë e konsoliduar, e këtij Komisioni, organizoi në datën **26.03.2019** një tryezë të dytë konsultimi me qëllim marrjen e mendimeve dhe opinioneve të institucioneve të interesuara dhe të grupeve të interesit.

Në këtë tryezë konsultimi morrën pjesë: përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përfaqësues të Bankës së Shqipërisë, ekspertë ndërkombëtarë dhe vendas të Misionit EURALIUS, përfaqësues të Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësor Privat, përmbaues gjyqësor privat, përfaqësues të Shoqatës Shqiptare të Bankave etj.

Në përmirësimin e projektligjit ka kontribuar me kërkesë të misionit EURALIUS V, eksperti ndërkombëtar Jos Uitdehaag, anëtar i Bordit Drejtues të Unionit Ndërkombëtar të Përmbaimit, duke trajtuar problematika të caktuara, paraqitur propozime konkrete për

formulime në nene të veçanta, nisur nga standardet dhe modelet më të mira të vendeve europiane.

Komisioni për Çështjet Ligjore, në mbledhjen e datës 15.04.2019, miratoi në parim projektligjin *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”, i ndryshuar*. Gjatë prezantimit në parim të projektligjit, relatori parashitri përpara të gjithë anëtarëve të komisionit punën intensive të zhvilluar në lidhje me procesin e konsultimit dhe përmirësimit të draftit të depozituar si nismë deputeti.

Nisur nga komentet e ardhura nga i gjithë procesi i konsultimit, nevoja për adresimin e problematikave të evidentuara në Analizën e Sistemit të Drejtësisë, por edhe për adresimin e problematikave të lindura nga zbatimi i ligjit aktual referuar standarteve më të mira ndërkombëtare, u konstatua se shtesat dhe ndryshimet e propozuara e tejkalojnë grupin e neneve që janë paraqitur për ndryshim në draftin fillestar.

Për këtë arsye, duke qenë se ndryshimet që u propozuan preknin pothuajse gjithë nenet e ligjit aktualisht në fuqi (vetëm 8 nene të pandryshuara nga 60 nene të ligjit aktual), nga grupi i punës referuar edhe diskutimeve të bëra në fazën e shqyrtimit në parim të projektligjit, nga komisioni përgjegjës për çështjet ligjore, u konkludua se këto shtesa dhe ndryshime nuk mund të trajtohen më si amendamente për ndryshime në ligjin aktual, por duhet të paraqitet në Komision si një draft i ripunuar, ku të jenë inkorporuar: si drafti i depozituar, ndryshimet e reja që propozohen ashtu edhe dispozitat e ligjit aktual që mbeten të pandryshuara.

Versioni i përmirësuar dhe i plotësuar i projektligjit, tashmë si një ligj i ri dhe jo më si një ligj ndryshues, u paraqit në komisionin përgjegjës për çështjet ligjore gjatë fazës së shqyrtimit nen për nen. Referuar shpjegimeve dhe argumenteve të relatorit nëpërmjet projektligjit të ri *“Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”* synohet:

a. të adresohet problematika e evidentuar në analizën e sistemit të drejtësisë për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat;

b. të sigurohet realizimi i qëllimit kryesor të këtij projektligji që është garantimi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si pjesë e parimit të procesit të rregullt ligjor referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese.

c. të hidhen bazat solide për zhvillimin e profesionit të përmbaruesit gjyqësor dhe statusin e tij profesional, përgjegjësisë së tij ligjore, garancive të procesit përmbarimor, marrëdhënieve institucionale, integritetit akademik të përmbaruesve gjyqësorë në përputhje me standartet më të mira ndërkombëtare në këtë fushë.

Gjatë shqyrtimit nen për nen të projektligjit Komisioni i kushtoi një vëmendje të posacme sugjerimeve dhe komenteve të paraqitura nga Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësore Privat, përfaqësuesit e të cilës ishin të pranishëm në çdo mbledhje. Komisioni adresoi një pjesë të konsiderueshme të sugjerimeve dhe vërejtjeve të paraqitura prej tyre, me qëllimin final që projektligji i ri të adresojë jo vetëm problematikat e lindura nga zbatimi i parashikimeve të ligjit aktual, por edhe të sigurojë nevojën për një qasje më të plotë me standartet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira në këtë fushë.

Si rezultat i këtij procesi, projektligji i ri “Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat” u diskutua dhe u miratua nën për nën në mbledhjet e datave 23.4.2019, 24.4.2019 dhe 26.4.2019 të zhvilluara në Komisionin përgjegjës për Çështjet Ligjore.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTLIGJIT

Projektligji ndahet në dy pjesë dhe përbëhet në tërësinë e tij nga 12 krerë dhe 91 nene, të cilat përcaktojnë mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor Privat, kriteret që duhet të përmbushin individët për të ushtruar detyrën e përmbarruesit gjyqësor privat, statusin, masat disiplinore, marrëdhëniet me institucionet shtetërore dhe me subjektet e tjera publike dhe private.

KREU I “Dispozita të përgjithshme” (nenet 1-4) përcakton dispozitat e përgjithshme që përfshijnë objektin e ligjit, fushën e zbatimit përkufizimin e termave kryesorë të përdorur në përmbajtjen e këtij projektligji dhe organizimin e shërbimit përmbarrimor gjyqësor privat.

Në lidhje me fushën e zbatimit (neni 2) në variantin e ri të projektligjit janë propozuar ndryshime në kuadër të harmonizimit të projektligjit me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile. Projektligji parashikon mundësinë e rritjes së gamës së shërbimeve të ofruara prej përmbarruesit gjyqësor privat, si pjesë e të drejtave të tij ligjore duke zgjeruar funksionalitetin dhe rolin e tij publik në sistemin e drejtësisë nëpërmjet asistencës së ofruar sistemit gjyqësor. Në kuptim të asistencës ndaj gjykatës, përmbarruesi gjyqësor privat do të kryejë njoftimet e akteve gjyqësore apo dokumenteve zyrtare në përputhje kjo dhe me ndryshimet e miratuara tashmë në Kodin e Procedurës Civile (ligji nr. 38/2017). Njëkohësisht duke marrë në konsideratë sugjerimet e paraqitura gjatë fazës së konsultimit, vecanërisht nga Dhoma Kombëtare e Përmbarruesve Gjyqësorë Privat dhe nga eksperti ndërkombëtar Jos Uitdehaag në harmoni me standartet e parashikuara në udhëzuesin e CEPEJ (paraprafi 34), është parashikuar kryerja e veprimtarive dytësore nga përmbarruesit gjyqësor privat ku mund të përmendim: njoftimin dhe kryerjen e mbledhjes së detyrimeve financiare me mirëkuptim, me kërkesë të të interesuarve; kryerjen e konstatimeve të fakteve, sendeve dhe dukurive lehtësisht të verifikueshme, që nuk kërkojnë njohuri specifike teknike sipas legjislacionit në fuqi, me kërkesë të të interesuarve etj. Aktivitetet e referuara në paragrafin 2 të nenit 2 janë aktivitete që Përmbarruesit Gjyqësorë kanë të drejtë t’i kryejnë në vendet e Bashkimit Evropian si (Belgjika, Franca, Holanda, Luksemburgu, Skocia, Spanja, Greqia, Çekia, Finlanda, Hungaria, Zvicra).

Kreu II “Shërbimi përmbarrimor gjyqësor privat” (nenet 5-14) normon disa çështje shumë të rëndësishme në lidhje me organizimin e këtij shërbimi.

Për sa i takon *organizimit të përmbarruesve gjyqësor privat* (neni 6) projektligji i ripunuar propozon një normim të qartë në projektligj të mënyrës së organizimit të përmbarruesve gjyqësorë privat. Në këtë dispozitë janë adresuar shqetësimet kryesore të Ministrisë së Drejtësisë,

si dhe janë adresuar pjesërisht sugjerimet e Dhomës. Element i rëndësishëm që vlerësohet se do të zgjidhë problematikat që derivojnë prej ofrimit të shërbimit përmbartimor privat deri sot nga ana e subjekteve thjesht tregtare përmbartimore, duke i vendosur këto të fundit në funksion të përmbushjes së plotë të misionit publik dhe përmbartimor, është vendosja e detyrimit taksativ të ofrimit të këtij shërbimi vetëm nga përmbartuesit gjyqësor të licencuar për këtë qëllim.

Në këtë kuadër projektligji parashikon mundësinë e përmbartuesve gjyqësorë privatë që të mund të organizohen në zyra të përmbartimit privat, duke u regjistruar në një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, por licenca e ushtrimit të veprimtarisë përmbartimore, është individuale dhe i përket vetëm individit të licencuar si përmbartues gjyqësor privat. Në rastin e organizimit në formën e zyrave të përmbartimit privat, projektligj përcakton në mënyrë detyruese se administratorë, ortakë dhe/ose aksionarë të zyrave të përmbartimit privat mund të jenë vetëm individët e licencuar si përmbartues gjyqësorë privatë. Bazuar në propozimet e paraqitura nga Ministria e Drejtësisë gjatë shqyrtimit në komision u shtua një parashikim sipas të cilit Qendra Kombëtare e Biznesit çregjistron brenda 3 diteve pune, një zyrë të përmbartimit privat me ortak të vëtem, kur ndryshojnë kushtet e parashikuara nga ky ligj, propozim i cili është në harmoni edhe me cilin “Për regjistrimin e biznesit”, i cili parashikon në nenin 48 gërma “ç” çregjistrimin sipas parashikimeve të ligjit të posaçëm.

Duke marrë në konsideratë modelin e ligjit të Kosovës, ligjin bullgar por edhe problematikën e evidentuar në analizën e sistemit të drejtësisë dhe rekomandimet e strategjisë, projektligji parashikon një dispozitë të vecantë lidhur me **numrin e përgjithshëm të përmbartuesve gjyqësor privat (neni 9)**. Udhërrëfyeni i 2009 i CEPEJ parashikon që shtetet anëtare duhet t’i kushtojnë një vëmendje të veçantë shpërndarjes gjeografike të përmbartuesve në mënyrë që të sigurohet një mbulim i përshtatshëm i territorit, konkurrencë e mjaftueshme dhe kompetenca tokësore të mirëpërcaktuara.

Projektligji parashikon që numri i përgjithshëm i përmbartuesve gjyqësorë privatë, që ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë si rregull nuk mund të jetë më i lartë se numri i përcaktuar nga raporti 1 përmbartues gjyqësor privat për çdo 20 000 banorë rezidentë, bazuar në të dhënat zyrtare të censusit të fundit të përgjithshëm të popullsisë dhe banesave. Ky numër është caktuar duke marrë në konsideratë modelet e vendeve të rajonit (Kosova, Bullgaria) si dhe numrin e përmbartuesve gjyqësorë që kanë aktualisht kanë licenca aktive në raport me numrin e përgjithshëm të popullsisë.

Kjo dispozitë u diskutua gjatë, gjatë shqyrtimit të projektligjit të komision ku përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë paraqitën shqetësimet e tyre në vecanti lidhur me heqjen e kriterëve mbi bazën e të cilave do të përcaktohet ky numër, por edhe me heqjen e kufizimeve për numrin e ndihmëspërmbartuesve.

Komisioni, vlerësoi se projektligji duhet të përcaktojë një mekanizëm të qartë ligjor për numrin e përmbartuesve gjyqësor privatë, i cili do të ndikojë pozitivisht në disiplinimin e ofrimit të shërbimit përmbartimor gjyqësor privat, kjo bazuar në praktikën më të mira evropiane. Në këtë këndvështrim Komisioni vlerësoi se pavarësisht numrit të përcaktuar në projektligj duhet të ketë edhe mekanizëm efektiv zhbllokues sipas të cilës ky numër të mos jetë i pandryshuar, por Ministri i Drejtësisë në varësi të nevojës publike dhe në bazë të propozimit të arsyetuar të Dhomës Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë, të mund të caktojë një numër më të

madh ose më të vogël të përmbauesve gjyqësorë privatë. Komisioni vlerësoi të nevojshme, që projektligji të përcaktojë disa kriterë bazë jo shteruese, mbi të cilat do të mbështet vendimarrja për përcaktimin e numrit të përmbauesve gjyqësorë privat, në çdo rreth gjyqësor, në respektim të parimit të objektivitetit dhe transparencës. Njëkohësisht ky parashikim vjen edhe i shoqëruar me një rregull kalimtar, i cili nuk cënon të drejtat e fituara nga përmbauesit aktual referuar parashikimeve të ligjit që është aktualisht në fuqi.

Kjo risi pritet të përmirësojë kontrollin mbi këtë profesion si dhe të rrisë performancën.

Neni 10 juridiksioni territorial nuk parashikon risi në krahasim me ligjin aktual dhe është në harmoni me parashikimet e bëra në nenin 516 të Kodit të Procedurës Civile.

Një dispozitë e rëndësishme e këtij projektligji në drejtim të mbrojtjes sociale të shtresave në nevojë është parashikimi i një neni të veçantë lidhur me *detyrimin për të kryer ekzekutimin* në rastin kur kreditor janë një kategori e caktuar subjektësh (*neni 11*). Propozimi për shtimin e këtij neni ka ardhur nga Dhoma, por formulimi është elaboruar edhe më tej duke parashikuar kategoritë, që aktualisht nuk janë të detyruara të parapagujnë tarifën përmbauesore, referuar parashikimeve të bëra në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë të Drejtësisë dhe Ministrisë të Financave aktualisht në fuqi.

Papajtueshmëritë me detyrën e përmbauesit gjyqësor (neni 12). Projektligji përcakton qartë kushtet e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit të përmbauesit gjyqësor privat dhe rastet kur mund të konsiderohet konflikt interesi. Reformulimi i propozuar detajon të gjitha elementet që konsiderohen si papajtueshmëri dhe trajton thelbin e problematikës. Ky parashikim adreson shqetësimet e Ministrisë së Drejtësisë dhe reflekton pjesërisht sugjerimet e Dhomës.

Gjatë shqyrtimit në komisionit, anëtarët e komisionit theksuan nevojën që, ky nen të parashikojë garancitë e nevojshme për të siguruar objektivitetin, paanshmërinë dhe shmangien e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrës së përmbauesit gjyqësor privat. Në këtë kuadër u bënë reformulimet e nevojshme në disa pika të tij. Gjithashtu me propozim të disa anëtarëve të Komisionit u vendos heqja e kufizimit sipas të cilit, përmbauesi gjyqësor privat nuk mund të jetë pjesë e organeve drejtuese të organizatave politike ose partive politike. Kjo në konsideratë të faktit se në parashikimet e ligjeve aktuale ka patur paqartësi lidhur me zbatimin e këtij parashikimi dhe njëkohësisht duke qënë se jemi përpara një profesioni të lirë, që licencohet dhe kontrollohet nga ministria e Drejtësisë, mekanizmat e parashikuara në përmbajtjen e projektligjit për garantimin e shmagies së konfliktit të interesit konsiderohen mëse të mjaftueshme duke marrë në konsideratë edhe shtimin e rasteve të cilat konsiderohen si konflikt interesi bazuar në propozimet e bëra gjatë shqyrtimit në Komision nga Ministria e Drejtësisë dhe ekspertët.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Ministrisë të Drejtësisë (neni 14) në krahasim me parashikimet e ligjit aktual janë shtuar duke parashikuar kompetencat e ministrit në lidhje me miratimin e kontratave në referencë të veprimtarisë dytësore të parashikuar për t'u kryer nga përmbauesit gjyqësorë privat sipas nenit 2 të projektligjit. Njëkohësisht në këtë nen u shtua edhe një parashikim i rëndësishëm lidhur me kompetencën e ministrit për hartimin e rregullave të detajuara lidhur me krijimin, mbajtjen dhe administrimin e arkivave.

Kreu III “Licencimi dhe regjistrimi”, (nenet 15-25) përbën edhe një nga Krerët më të rëndësishëm të këtij projektligji.

Kushtet e licencimit të përmbauesve gjyqësor privat (neni 16), janë hartuar rishtazi duke marrë në konsideratë parashikimet e bëra nga ligjet e tjera, që rregullojnë profesionet e lira si nga ligji “Për noterinë”, ligji “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” si dhe pasi janë analizuar standardet europiane. Projektligji propozon forcimin e kushteve për t’u licencuar si përmbaues gjyqësor privat, duke përcaktuar shprehimisht jo vetëm kushte të përgjithshme të arsimit, por edhe kërkesën për kryerjen e trajnimit fillestar (1 vjeçar) dhe punësimin me kohë të plotë pranë një përmbauesi gjyqësor privat ose zyrë të përmbaimit privat, si ndihmës përmbaues për një periudhë jo më të vogël se 2 vjet, pas kryerjes së trajnimit të detyrueshëm fillestar.

Përcaktimi i kriterëve dhe kushteve ligjore të qarta dhe transparente për të ushtruar profesionin e përmbauesit gjyqësor privat, synon prurjet më cilësore dhe me integritet moral dhe profesional.

Hyrja në profesion në këtë projekt kalon nëpër disa faza të zhvillimit të karrierës profesionale, që duhet të kalojë një jurist i diplomuar për të ushtruar profesionin e përmbauesit gjyqësor privat.

Kriteret për të ushtruar profesionin e përmbauesit fillojnë me: a) ndjekjen e trajnimit fillestar (1 vjeçar), dhe vazhdon dhe përshkallëzohet me fazat e tjera atë të ushtrimit të detyrës së ndihmës përmbauesit për një periudhë 2 vjeçare për t’u finalizuar me provimin e kualifikimit profesional si dhe betimin dhe regjistrimin. Sistemi i ri i propozuar në këtë projekt parashikon një afat kohor të paktën 3 vjeçar (1 vit trajnim fillestar si dhe 2 vite pune me kohë të plotë si ndihmës përmbaues) përpara hyrjes në provimin e kualifikimit dhe licencimin si përmbaues gjyqësor privat nga Ministri i Drejtësisë.

Procesi i formimit fillestar dhe trajnimit vazhdues të detyrueshëm (nenet 17, 18 dhe 22) janë rregulluar sipas standardeve ndërkombëtare duke synuar formim cilësor të kandidatëve për përmbaues gjyqësor privatë dhe përmbaues të kualifikuar. Qëllimi i trajnimit fillestar është përgatitja e kandidatëve me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme profesionale për licencimin si përmbaues gjyqësor privat. Ndërkohë trajnimi vazhdues ka si qëllim të garantojë përditësimin e njohurive teorike dhe praktike të përmbauesve gjyqësorë privat të licencuar por edhe të ndihmës përmbauesve në funksion të sigurimit të standarteve më të larta gjatë ushtrimit të profesionit. Kodi Global i Përmbaimit të UIHJ sanksionon, që përmbauesit gjyqësorë duhet të përmbushin detyrimet në lidhje me trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm. Për më tepër, udhërrëfyeni i 2009 i CEPEJ detyron që vetëm kandidatët me trajnim dhe eksperiencë të përshtatshme me kompleksitetin e detyrës mund të emërohen si përmbaues nga shteti.

Procesi i trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm do të kryhet nga Qendra Kombëtare e Trajnimit të Përmbauesve, e cila do të ngrihet pranë Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë. Qendra e Trajnimit, financohet dhe administrohet nga Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë.

Për shkak të rëndësisë që ka procesi i trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm në formimin profesional të kandidatëve për përmbaues gjyqësor privat, ndihmës përmbauesve dhe

përmbauesve gjyqësor privat, projektligji i jep një rol të rëndësishëm Ministrisë së Drejtësisë, të cilit i jepen tagrat e miratimit të programeve të trajnimit të detyrueshëm fillestar dhe të trajnimit të vazhdueshëm, me propozim të Dhomës. Njëkohësisht Ministri i Drejtësisë do të miratojë Rregulloren e Qendrës së Trajnimit me propozimin e Dhomës.

Neni 20 parashikon rregulla të hollësishme lidhur me provimin e kualifikimit dhe përbërjen e Komisionit të Kualifikimit. Gjatë shqyrtimit në komision u diskutua lidhur me domosdoshmërinë për të përcaktuar rregulla të detajuara të vlerësimit të provimit në këtë projektligj apo delegimin e tyre me akt nënligjor. Në përfundim komisioni duke vlerësuar domosdoshmërinë për realizimin e një procesi sa më transparent dhe objektiv në këtë fazë përfundimtare të lidhur drejtpërdrejt me dhënien e licencës së përmbauesit gjyqësor privat, por duke marrë në konsideratë edhe parashikimet e bëra në ligje të ngjashme, që rregullojnë profesionet e lira në sistemin e drejtësisë si Ligji “Për noterinë”, apo edhe parashikimet e bëra në Kreun që trajton Shkollën e Magjistraturës në ligjin 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, me qëllim që të sigurohet licencimi i individëve sa më cilësorë dhe profesional si përmbaues gjyqësor privat, vlerësoi të nevojshme që projektligji të vendosë rregulla të detajuara dhe specifike lidhur me provimin e kualifikimit.

Neni 21 i projektligjit përcakton rregulla të detajuara lidhur me regjistrimin dhe fillimin e veprimtarisë së përmbauesit të gjyqësor të licencuar nga Ministri i Drejtësisë. Ky nen sanksionon detyrimin e përmbauesit gjyqësor privat të licencuar sipas kushteve të përcaktuara në ligj për të bërë betimin dhe për t’u regjistruar. Një risi e këtij projektligji është përcaktimi i kushteve, që duhet të përmbushë përmbauesi i licencuar përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë si përmbaues gjyqësor privat, kushte të cilat janë përcaktuara bazuar në standartet e udhëzuesit të CEPEJ. Gjatë shqyrtimit në Komisionin e Ligjeve, bazuar në propozimet e Ministrisë së Drejtësisë por edhe të Dhomës u miratuan disa saktësime në lidhje me këtë nen të cilat synojnë qartësimin e kushteve për fillimin e veprimtarisë së përmbauesve gjyqësorë privat dhe njëkohësisht, saktësimin e rasteve kur një përmbaues gjyqësor privat konsiderohet se nuk është regjistruar dhe nuk ka filluar veprimtarinë përmbauese.

Neni 23 trajton elementët që duhet të përmbajë Regjistri Publik të përmbauesve gjyqësor privat dhe Regjistrin Unik të Përmbauesve Gjyqësor dhe Zyra të Përmbaimit Privat. Kjo dispozitë vjen si propozim i Ministrisë së Drejtësisë duke u bazuar në regjistrat e krijuara dhe që administrohen tashmë nga kjo ministri.

Neni 24 sanksionon regjistrin qendror të kërkesave për vënie në ekzekutim të urdhrave të ekzekutimit, e cila është ngritur tashmë pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe që funksionon si bazë të dhënash shtetërore mbështetur në VKM nr. 433/2011 “Për përcaktimin e mënyrës së funksionimit, të administrimit dhe të ndërveprimit të Sistemit të Menaxhimit Elektronik të Çështjeve të Përmbaimit Gjyqësor (ALBIS), si regjistri qendror i kërkesave për vënie në ekzekutim të urdhrave të ekzekutimit”. Bazuar në sugjerimet e Ministrisë së Drejtësisë dhe të Dhomës, gjatë shqyrtimit në komision u shtua një parashikim sipas të cilit, Sistemi i Administrimit të të Dhënave dhe Informacionit të Përmbauesit që funksionon pranë Dhomës

ndërvepron me sistemin ALBIS dhe me bazat e tjera të të dhënave shtetërore, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Neni 25 reflekton pjesërisht sugjerimet e Dhomës dhe thekson faktin që veprime procedurale përmbartimore me pasoja për palët mund të kryhen vetëm nga përmbartues gjyqësor privat të licencuar dhe të regjistruar.

Kreu IV “Pezullimi, heqja e licencës dhe cregjistrimi i përmbartuesve gjyqësor privat” (nenet, 26, 27 dhe 28)

Në këtë Kre janë trajtuar rastet e pezullimit, heqjes së licencës dhe cregjistrimi i përmbartuesve gjyqësorë privatë. Projektligji parashikon në mënyrë të detajuar rastet e pezullimit nga detyra e përmbartuesit gjyqësor privat me vendim të Ministri ku mund të përmendim: rastin e fillimit të një procedure cregjistrimi kur ka dyshime se licencimi është bërë në kundërshtim me kushtet ligjore; në rastin e kufizimit të zotësisë për të vepruar, mospagimit të kuotës vjetore të anëtarësisë etj.

Gjatë shqyrtimit në Komision diskutimi u fokusua në rastin e pezullimit për shkak të regjistrimit të një procedimi penal në rastin e kryerjes së veprës penale të “shpërdorimit të detyrës” dhe/ose për veprat që lidhen me pengimin e ekzekutimit. Lidhur me këtë çështjet pati diskutime të ndryshme nga anëtarët e komision dhe diskutimi i përqëndrua në nevojën për dhënien e garancive të nevojshme të cilat shmangin abuzimet, por edhe janë në përputhje me parashikimet e bëra në Kodin e Procedurës Penale. Në këtë aspekt Komisioni vendosi të riformulojë paragrafin përkatës duke parashikuar që pezullimin në rast se ndaj tij është caktuar masa e sigurimit personal me arrest, për vepra penale që lidhen me “shpërdorimin e detyrës” dhe/ose me pengimin e ekzekutimit.

Projektligji trajton edhe rastet e pezullimit të përkohëshëm me kërkesë të vetë përmbartuesit gjyqësor privat për shkaqe shëndetësore, përkujdesje ndaj fëmijës së mitur apo edhe emërimit në një funksion publik.

Me qëllim garantimin dhe mbrojtjen e interesit publik gjatë një procedure përmbartimore projektligji parashikon edhe rastet e c`regjistrimit të përmbartuesit gjyqësor privat. Një nga rastet e c`regjistrimit është edhe mbushja e moshës së pensionit të pleqërisë. Lidhur me këtë kriter u morr në konsideratë standarti i vendosur nga Gjykata Kushtetuese në rastin e profesionit të noterit, nëpërmjet vendimit nr. 3/2005. Sipas vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese: “vendosja e një kriteri të moshës në ushtrimin e veprimtarisë noteriale është kushtetues, por njëkohësisht nuk është drejtpërdrejtë i lidhur me moshën e pensionit por me parimin e forcimit të rregullit në ushtrimin e aktivitetit dhe në mundësimin e ofrimit të shërbimeve të standardeve të larta e në dobi të publikut”.

Kreu V “Organet drejtuese dhe kompetencat e Dhomës Kombetare të Përmbartuesve Gjyqësor Privat” (nenet 29- 35),

rregullon organizimin e brendshëm të Dhomës Kombetare të Përmbartuesve Gjyqësor Privat. Projektligji ka saktësuar statusin juridik të Dhomës, si dhe ka specifikuar që anëtarësimi në këtë Dhomë është detyrë dhe jo një e drejtë e përmbartuesve gjyqësorë. Dispozitat e këtij Kreu kanë synuar të ruajnë organizimin e brendshëm

të Dhomës sipas parashikimevet të ligjit aktual duke saktësuar dhe përcaktuar në mënyrë të qartë kompetencat e secilit organ drejtues. Rregulla më të hollësishme lidhur me organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese janë deleguar për rregullim nga Statuti i Dhomës.

Përgjatë diskutimeve të grupit të punës si dhe në tryezat e konsultimit është diskutuar gjërësisht mundësia e ngritjes së Qendrës së Zhvillimit të Ankandeve, si një vend publik ku mund të zhvillohen ankandet në mënyrë publike dhe transparente. Për shkak se ngritja e kësaj Qendre lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me një fazë të ekzekutimit të titujve ekzekutivë (zhvillimi i ankandeve) u vlerësua e nevojshme që ngritja e kësaj Qendre duhet të paraprihet nga ndryshime në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

Kreu VI “Të drejtat, detyrat, përgjegjësitë dhe mbrojtja e veçantë e përmbauesve gjyqësor privat të licencuar” (nenet 36-44). Dispozita që trajton të drejtat e përmbauesit gjyqësor privat në karahasim me ligjin aktual reflekton ndryshimet e propozuara në lidhje me veprimtarinë dytësore të përmbauesit gjyqësor privat. Njëkohësisht ndryshimet e propozuara synojnë edhe harmonizimin me ndryshimet në parashikimet e KPC.

Nenet 36 dhe 37 janë në harmoni me standardet e përcaktuara në udhëzuesin e CEPEJ por edhe reflektojnë sugjerimet e Dhomës dhe të Ministrisë së Drejtësisë. Në vijim të sugjerimeve të Ministrisë së Drejtësisë gjatë shqyrtimit në komision u përcaktua që tarifat për veprimtarinë dytësore të përmbauesit gjyqësor privat të përcaktohen me udhëzim të Ministrisë me propozim të Dhomës.

Nenet 38-41 ruajnë të njëjta standarde me parashikimet e vendosura në ligjin aktual. Në këto dispozita janë reflektuar edhe disa saktësime të sugjeruara nga Ministria e Drejtësisë dhe Dhoma gjatë fazës së shqyrtimit të projektligjit në Komision.

Një nga çështjet më të rëndësishme të këtij Kreu është neni 42, i cili ka të bëjë me sanksionimin ligjor të llogarisë bankare të përmbauesit gjyqësor, dhe që përbën një nga aspektet kyçe në drejtim të përgjegjësisë profesionale të përmbauesit gjyqësor privat. Parashikimi i detajuar ligjor i llogarisë bankare të përmbauesit gjyqësor, është materializim i përgjegjësisë ligjore të subjektit përmbaues dhe një formë e shtuar kontrolli dhe transparence për veprimtarinë e tij procedurale edhe për saktësinë dhe ekskluzivitetin e vlerave monetare lidhur me procesin përmbaues, në llogari dhe funksion të tij. Përcaktimi për herë të parë i transferimeve të shumave të sekuestruara në terma të afateve të përcaktuara, parandalon problematikat e zvarritjes në kohë të materializimit të të drejtës së kreditorit dhe garantimin e plotë të së drejtës së tij materiale. Në hartimin e këtij neni një kontribut të rëndësishëm nga dhënë eksperti ndërkombëtar i misionit EURALIS. Kjo dispozitë ka marrë në konsideratë standartet e udhëzuesit të CEPEJ dhe në përmbajtjen e saj janë reflektuar pjesërisht për disa pika sugjerimet e Dhomës dhe janë pasqyruar riformulimet e përcjella nga Banka e Shqipërisë.

Neni 43 synon të adresojë problematika të konstatuara gjatë zbatimit të ligjit aktual nga Ministria e Drejtësisë me qëllim qartësimin e procedurave që do të zbatohen pas heqjes së licencës së përmbauesit gjyqësor privat.

Kreu VII “Marrëdhëniet me palët në proces ekzekutimi dhe me të tretët” (nenet 46-54) trajtojnë marrëdhënien me palën në proces ekzekutimi dhe me të tretët.

Neni 46 i projektligjit ka si qëllim sigurimin e një balance të drejtë, në rast të zgjidhjes së marrëdhënies kontraktuale nga përmbauesi gjyqësor ose për shkak të tij duke parashikuar që përmbauesi gjyqësor privat në këtë rast mban pjesën e shumës të marrë si tarifë fikse për veprimet përmbaimore të kryera deri në castin e zgjidhjes së kontratës. Ndërkohë do të jetë Ministri i Drejtësisë që në kontratën e shërbimit që miratohet prej tij, do të përcaktojë shumën e tarifës fikse, që do të mbahet nga përmbauesi gjyqësor privat, për veprimet e kryera prej tij. Formulimi i këtij neni është bërë me propozim të Ministrisë së Drejtësisë.

Nenet 48 dhe 49 të projektligjit adresojnë një nga shqetësimet më kryesore të paraqitura nga grupet e interesit gjatë fazës së konsultimit të lidhur me vijueshmërinë e veprimeve përmbaimore në rastin e heqjes së licencës dhe çregjistrimit nga regjistrimi i përmbauesve gjyqësor privat, ose në rast se përmbauesi gjyqësor privat nuk mund të përmbushë detyrat e tij për shkak të sëmundjes, mungesës ose pezullimit. Në këtë aspekt për të garantuar vijimin e veprimtarive përmbaimore dhe respektimin e të drejtave të palëve është propozuar figura e përmbauesit gjyqësor privat zëvendësues. Përmbauesi gjyqësor privat zëvendësues caktohet nga Ministri i Drejtësisë nga lista e vënë në dispozicion nga Dhoma dhe gëzon të njëjtat të drejta dhe detyrime si përmbauesi gjyqësor privat që zëvendëson. Rregulla të hollësishme në lidhje me modalitetet, afatet, mënyrën e caktimit të përmbauesit gjyqësor zëvendësues do të përcaktohen me udhëzim të Ministrit pas marrjes së mendimit të Dhomës. Figura e përmbauesit gjyqësor privat zëvendësues mbështeten në disa modele të vendeve të rajonit, të cilat kanë një sistem të ngjashëm me atë të vendit tonë ku mund të përmendim modelin e ligjit të Kosovës, ligjit të Bullgarisë etj.

Nenet 51, 52, 53 dhe 54 normojnë marrëdhëniet e përmbauesit gjyqësor privat me palën debitore, të tretët, ndihmën nga Policia e Shtetit si dhe përgjegjësinë e përmbauesit gjyqësor ndaj palëve në proces ekzekutimit dhe ndaj të tretëve. Në këtë aspekt është parashikuar detyrimi i institucioneve që të ndihmojnë përmbauesin gjyqësor gjatë procedurës përmbaimore dhe njëkohësisht është parashikuar në një dispozitë të veçantë ndihma dhe bashkëpunimi, që duhet të ofrojë Policia e Shtetit bazuar në parashikimet e Kodit të Procedurës Civile. Vlen për tu theksuar parashikimi i bërë lidhur me ekzekutimin e titujve ekzekutiv me objekt “kujdestari të fëmijëve”, ku propozohet detyrimi për njoftimin e njësisë për mbrojtjen e fëmijëve në bashki si dhe asistencë e një psikologu.

Dispozitat e **Kreut të VIII “Tarifat”**, (*nenet 55-57*) që përcaktojnë tarifat përmbaimore janë amenduar para 2 vjetësh, pra nuk ka nevojë për ndërhyrje. Në këtë kre janë kryer vetëm disa redaktime sipas rregullave të teknikës legjislative.

Kreu IX “Kontrolli dhe mbikëqyrja e veprimtarisë së përmbauesve gjyqësorë privat” (*nenet 58-60*).

Inspektimi i veprimtarisë së përmbauesve gjyqësorë privat nga Ministria dhe nga Dhoma është në përputhje me standardet ndërkombëtar¹ si dhe dispozita të ngjashme janë të pranishme

¹ Udhëzimet CEPEJ 2009 mbi Përmbaimin (Paragrafi 75) dhe Rekomandimi Rec(2003)17 i Këshillit të Ministrave të KE për shtetet anëtare mbi përmbaimin (Paragrafi IV.4)

në vendet e rajonit (p.sh. Kosova, Serbia, Bullgaria) si dhe vendet e Evropës Perëndimore, si Holanda.

Propozimet zgjidhin çështjen e mbivendosjes së kompetencave të Ministrisë së Drejtësisë me Dhomën Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësor Privat, duke bërë në këtë mënyrë një ndarje të tillë konceptuale:

- Ministria e Drejtësisë ushtron tagrat e kontrollit;
- Dhoma ushtron mbikqyrjen e shërbimit të përmbaimit privat në lidhje me respektimin e Kodit të Etikës, standarteve profesionale dhe përmbushjen e detyrimeve të përmbauesve gjyqësor privat si anëtarë të Dhomës;

Kontrolli i veprimtarisë së përmbauesve gjyqësor privat kryhet nga nëpunësit e strukturës përgjegjëse në Ministri. Në rastet e mungesës së burimeve njerëzore, si dhe mbulimit të fushave specifike, projektligji parashikon mundësinë e angazhimit të ekspertëve të jashtëm të pavarur. Angazhimi i tyre në inspektim është një mundësi për të rritur cilësinë e inspektimeve.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i kontrolli të veprimtarisë përmbaimore është parashikuar të realizohet nëpërmjet raportit vjetor statistikor që përmbauesi gjyqësor privat ka detyrimin t'i paraqesë Ministrisë dhe Dhomës. Ky raport përfshin edhe informacion në lidhje me administrimin e llogarisë bankare të veçantë.

Kreu X “Procedimi disiplinor” (nenet 61 deri 83). Kreu që trajton procedimin disiplinor është rikonceptuar sipas standardeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

GJEDNJ, bazuar në jurisprudencën e saj, përfshin procesin administrativ dhe disiplinor në fushëveprimin e pjesës penale të nenit 6 të KEDNJ, nëse përmbushen kushtet: (1) klasifikimi i normës në të drejtën e brendshme; (2) shtrirja e normës (përtej një grupi të mirëpërcaktuar) dhe qëllimi i sanksionit (parandalues dhe ndëshkues); (3) natyra dhe ashpërsia e sanksionit.

Këto standarde janë përcaktuar në çështje të hershme që datojnë në vitet 1970 dhe 1980² dhe janë përforcuar dhe rikonfirmuar nga GJEDNJ në jurisprudencën e saj bashkëkohore³. Për më tepër, Kodi Global i Përmbaimit të UIHJ kërkon që procedura disiplinore të zbatojë rregullat e procesit të rregullt ligjor dhe të zhvillohet përpara një organi të pavarur.

Në këtë aspekt, është e rëndësishme të detajohen procedurat e hetimit administrativ, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve nën hetim apo procedim disiplinor, rregullat e seancës dëgjimore, apelimi dhe sigurimi i paanshmërisë dhe pavarësisë së Komisionit Disiplinor. Dispozitat e reja kanë synuar gjithashtu të harmonizojnë këtë projektligj me ligjin e miratuar rishtazi nr.110/2018 “Për noterinë”.

Kuadri ligjor aktual i procedimit disiplinor të përmbauesve është analizuar në "Raportin e Vlerësimit për Ekzekutimin e Vendimeve Civile dhe Tregtare në Shqipëri" të TAIEK-it, i cili vëren se "sipas legjislacionit aktual në Shqipëri, procesi disiplinor kundrejt përmbauesit gjyqësor privat perceptohet thjesht si procedurë administrative pa marrë parasysh obligimin për respektimin e rregullave të "procesit të rregullt ligjor"”.

Procesi i hetimit është një risi e këtij projektligji dhe është i përshtatur me standardet evropiane për të drejtat e njeriut të përmendura më sipër dhe është sjellë në harmoni me ligjin “Për

² shih Engel dhe të tjerë k. Hollandës, 8/6/1976, Nr. aplikimi 5100/71; Öztürk k. Gjermanisë, 21/2/1984, Nr. aplikimi 8544/79; Eber k. Zvicrës, 22/5/1990, Nr. aplikimi 11034/84; Bendenoun k. Francës, 24/02/1994, Nr. aplikimi 12547/86.

³ shih Janosevic k. Suedisë, 23/07/2002, Nr. aplikimi 34619/97; Jussila k. Finlandës 23/11/2006, Nr. aplikimi 73053/01.

noterinë”. Për sa i përket procedurës disiplinore, është zgjedhur një model ku Ministria e Drejtësisë ka rolin kryesor inspektues, por është bërë një ndarje midis inspektimit, hetimit ndaj shkeljeve të mundshme disiplinore dhe në shqyrtimin e çështjes dhe vendimmarjen në përfundim të procedurës disiplinore.

Nenet 73 deri në 80 rregullojnë krijimin dhe funksionimin e Komisionit Disiplinor, seancën dëgjimore dhe rastet e mbylljes së procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore, të drejtat dhe detyrimet e palëve gjatë procedimit disiplinor, si dhe vendimmarjet e Komisionit Disiplinor në lidhje me procedimin disiplinor. Siç u shtjellua më sipër, edhe procedimi disiplinor është hartuar në sinkron me parashikimet e ligjit për noterinë.

Lidhur me Komisionin Disiplinor, parashikohet që në përbërje të Komisionit të ketë: 1 anëtar që zgjidhen nga Ministri i Drejtësisë, 1 anëtarë të zgjedhur nga Dhoma dhe 1 anëtar nga Shkolla e Magjistraturës. Kriteret e parashikuara për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Disiplinor, synojnë të sigurojnë pjesëmarrjen në Komision të juristëve me përvojë dhe me integritet të lartë. Siç u përmend dhe më sipër, është synuar të arrihet pavarësia dhe paanësia e Komisionit.

Në këtë Kre (*nenet 81 deri në 83*) normohet gjithashtu edhe publikimi i vendimeve për dhënien e një mase disiplinore, regjistrimi i tyre në regjistrimin përkatës që mbahet dhe administrohet nga Ministria e Drejtësisë dhe nga Dhoma si dhe afatet për fshirjen e masave disiplinore nga regjistri.

Kreu XI “Shkeljet dhe masat disiplinore” (*nenet 84 deri në 87*) Këto dispozita janë hartuar duke ruajtur standardet e vendosura në ligjin aktualisht në fuqi nr. 10031/2008, për sa i takon kategorizimit të masave disiplinore. Pavarësisht kësaj projektligji propozon një shtjellim të mëtejshëm të veprimeve dhe mosveprimeve që përbëjnë shkelje disiplinore, bazuar në propozimet e paraqitura nga eksperti ndërkombëtar i misionit EURALIUS.

Vendimmarja për dhënien e masave disiplinore i përket vetëm Komisionit Disiplinor.

Në përputhje me parimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor është parashikuar edhe e drejta e ankimit pranë gjykatës administrative kompetente.

Për sa i takon masave disiplinore, gjatë shqyrtimit në Komision me qëllim garantimin e një parimit të proporcionalitetit ndërmjet shkeljeve të parashikuara dhe masave përkatëse disiplinore u rishikuan masat e gjobave si dhe afati i pezullimit të licencës.

Kreu XII parashikon dispozitat kalimtare dhe të fundit (*nenet 88-91*) Ky Kre përmban dispozitat e fundit që rregullojnë mënyrën se si do të zbatohet ky ligj, rregullimet kalimtare, institucionet përgjegjëse dhe afatet për miratimin e akteve nënligjore, shfuqizimin e akteve që bien ndesh me ligjin, si dhe momentin e hyrjes në fuqi të ligjit. Një vëmendje e vecantë i është dhënë respektimit të parimeve të sigurisë juridike dhe të drejtave të fituara. Në këtë aspekt është parashikuar që dispozitat e këtij ligji lidhur me licencimin e përmbauesve gjyqësor privat, nuk prekin certifikatat e aftësisë profesionale të lëshuara nga Ministri i Drejtësisë dhe licencat për përmbaues gjyqësor privat, të lëshuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, për aq sa nuk bien ndesh me parashikimet e këtij ligji. Njëkohësisht është propozuar që parashikimet në lidhje me numrin e përmbauesve gjyqësor privat, nuk sjellin pasoja për certifikatat e aftësisë profesionale të përmbauesve gjyqësorë privatë nuk cenojnë selinë ekzistuese të veprimtarisë së përmbauesve gjyqësorë privatë ose të zyrave të përmbaimit privat, deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

VII PËRFUNDIME

Në përfundim të shqyrtimit dhe diskutimit, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, konstatoi se:

- Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm, miratoi projektligjin sipas **tekstit integral bashkëlidhur këtij raporti**, i cili i përcillet për votim seancës plenare.

RELATOR

KRYETAR

ALKET HYSENI

ULSI MANJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____ / 2019

“PËR SHËRBIMIN PËRMBARIMOR GJYQËSOR PRIVAT”

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj ka si objekt përcaktimin e mënyrës se organizimit dhe të funksionimit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Privat, kriteret që duhet të përmbushin individët për të ushtruar detyrën e përmbaruesit gjyqësor privat, statusin, masat disiplinore, detyrat, përgjegjësitë, rregullat e caktimit të tarifave si dhe marrëdhëniet me institucionet shtetërore dhe me subjektet e tjera publike dhe private.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për përmbauesit gjyqësorë privatë, që kryejnë veprimet e tyre procedurale për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, Kodit Civil, akteve të tjera ligjore, si dhe për subjektet e tjera private dhe shtetërore, që përfshihen në procesin e ekzekutimit.
2. Ky ligj zbatohet edhe për veprimtaritë dytësore që kryhen nga përmbauesi gjyqësor privat dhe që përfshijnë:
 - a) kryerjen e njoftimit të akteve gjyqësore dhe dokumenteve zyrtare;
 - b) njoftimin dhe kryerjen e mbledhjes së detyrimeve financiare me mirëkuptim, me kërkesë të të interesuarve;
 - c) kryerjen e konstatimeve të fakteve, sendeve dhe dukurive lehtësisht të verifikueshme, që nuk kërkojnë njohuri specifike teknike sipas legjislacionit në fuqi, me kërkesë të të interesuarve;
 - ç) kryerjen e shitjes së sendeve në ankand publik me kërkesë të të interesuarve.

Neni 3

Përkufizime

Për qëllimin e zbatimit të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Dhoma”, në kuptim të këtij ligji është Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë.
- b) “Kandidat përmbaues” është individ i kryer trajnimin e detyrueshëm fillestar 1-vjeçar pranë Qendrës Kombëtare të Trajnimit të Përmbauesve.
- c) “Licenca e ushtrimit të veprimtarisë përmbaimore”, (*mëposhtë licenca*) është dokumenti zyrtar i lëshuar nga Ministria, që i jep të drejtën një individ për kryerjen e veprimtarisë përmbaimore.
- ç) “Ministri”, i referohet ministrit përgjegjës për çështjet e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë.
- d) “Ministria” i referohet ministrisë përgjegjëse për çështjet e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë.
- dh) “Ndihmës përmbaues” është individ i ka përfunduar trajnimin e detyrueshëm fillestar 1-vjeçar dhe që mbështet administrativisht përmbauesin gjyqësor privat në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- e) “Përmbaues gjyqësor privat”, individ i licencuar nga Ministri dhe i regjistruar në regjistrin e përmbauesve gjyqësorë privat në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
- ë) “Procedura përmbaimore”, nënkupton çdo veprim të ndërmarrë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile dhe parashikimet e këtij ligji me qëllim ekzekutimin e titujve ekzekutivë;
- f) “Qendra e Trajnimit”, në kuptim të këtij ligji, është Qendra Kombëtare e Trajnimit të

Përmbaruesve.

- g) “Veprimtari dytësore e përmbaruesit gjyqësor privat” është veprimtaria që kryhet sipas përcaktimeve të këtij ligji vetëm nga përmbaruesi gjyqësor privat.
- gj) Termat “kandidat përmbarues”, “ndihmës përmbarues”, “përmbarues gjyqësor privat” nënkuptojnë çdo individ që përmbush kriteret e përcaktuara në këtë ligj, pavarësisht gjinisë.

Neni 4

Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor

Shërbimi Përmbarimor në Republikën e Shqipërisë organizohet në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor dhe në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor të organizuar mbi baza private, sipas këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore.

KREU II

SHËRBIMI PËRMBARIMOR GJYQËSOR PRIVAT

Neni 5

Subjektet që ushtrojnë shërbimin përmbarimor gjyqësor privat

1. Veprimet përmbarimore kryhen vetëm nga individë, që janë pajisur me licencën individuale të ushtrimit të veprimtarisë përmbarimore, në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë ligj, nën përgjegjësinë vetjake të tyre.
2. Përmbaruesi gjyqësor privat i ushtron veprimet përmbarimore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe Kodin e Procedurës Civile.

Neni 6

Organizimi i përmbaruesve gjyqësorë

1. Përmbaruesi gjyqësor privat ushtron veprimtarinë në mënyrë individuale.
2. Përmbaruesit gjyqësorë privatë mund të organizohen në zyra të përmbarimit privat, duke u regjistruar në një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe

shoqëritë tregtare. Licenca e ushtrimit të veprimtarisë përmbarimore, është individuale dhe i përket vetëm individit të licencuar si përmbarues gjyqësor privat.

3. Administratorë, ortakë dhe/ose aksionarë të zyrave të përmbarimit privat mund të jenë vetëm individët e licencuar si përmbarues gjyqësorë privatë. Përmbaruesi gjyqësor privat mund të jetë administrator, ortak dhe/ose aksionar vetëm pranë një zyre të përmbarimit privat.

4. Zyrat e përmbarimit privat duhet të kenë si objekt eskkluziv të veprimtarisë së tyre tregtare vetëm aktivitetet e parashikuara në nenin 2 të këtij ligji.

5. Qendra Kombëtare e Biznesit regjistron një zyrë të përmbarimit privat në regjistrin tregtar, vetëm pasi vërteton përmbaruesin e kushteve ligjore të parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni.

6. Qendra Kombëtare e Biznesit çregjistron brenda 3 diteve pune, një zyrë të përmbarimit privat me ortak të vëtem, kur ndryshojnë kushtet ligjore të parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni.

Neni 7

Funksioni publik i Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Privat

1. Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Privat është një funksion i pavarur me karakter publik, i cili ushtrohet nga përmbaruesit gjyqësorë privatë dhe zyrat e përmbarimit privat.

2. Përmbaruesit gjyqësorë privatë dhe zyrat e përmbarimit privat, në ushtrimin e funksioneve të tyre, i nënshtrohen zbatimit të dispozitave të këtij ligji, Kodit të Procedurës Civile, Kodit Civil dhe ligjeve të tjera për ekzekutimin e titujve ekzekutivë.

Neni 8

Statusi ligjor i përmbaruesit gjyqësor privat

1. Përmbaruesi gjyqësor privat kryen dhe mban detyrën në emër dhe nën përgjegjësinë e tij vetjake.

2. Vetëm individët e licencuar, sipas kriterëve dhe rregullave të përcaktuara në këtë ligj, mund të kryejnë procedura ekzekutimi brenda funksionit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor të organizuar mbi baza private dhe/ose veprimtari dytësore sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 9

Numri i përgjithshëm i përmbaruesve gjyqësorë privatë

1. Numri i përgjithshëm i përmbaruesve gjyqësorë privatë, që ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë si rregull nuk mund të jetë më i lartë se numri i përcaktuar

nga raporti 1 përmbaues gjyqësor privat për çdo 20 000 banorë rezidentë, bazuar në të dhënat zyrtare të censusit të fundit të përgjithshëm të popullsisë dhe banesave. Ministri, në varësi të nevojës publike dhe në bazë të propozimit të arsyetuar të Dhomës, mund të caktojë një numër më të madh ose më të vogël të përmbauesve gjyqësorë privatë.

2. Ministri, pasi të ketë marrë mendimin me shkrim të Dhomës dhe pa tejkalluar numrin e përgjithshëm të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, përcakton me urdhër të paktën çdo 5 vjet numrin e përmbauesve gjyqësor privat në çdo rreth gjyqësor.

Kriteret për përcaktimin e numrit të përmbauesve gjyqësor privat, në çdo rreth gjyqësor bazohen në mënyrë të veçantë në:

- a) vëllimin minimal të punës të veprimtarisë përmbaimore;
- b) zhvillimin ekonomik rajonal;
- c) veçoritë e territorit dhe mjetet e komunikimit dhe të transportit.

3. Numri i përgjithshëm i ndihmës përmbauesve nuk mund të jetë më i lartë se një e katërta e numrit të përgjithshëm të përmbauesve gjyqësorë privatë me status aktivë.

4. Përmbauesi gjyqësor ose zyra e përmbaimit privat mund të ketë selinë në çdo rreth gjyqësor ku nuk është plotësuar numri i përmbauesve sipas përcaktimeve të këtij neni.

5. Ministria dhe Dhoma, publikojnë dhe përditësojnë hartën e shpërndarjes gjeografike të përmbauesve gjyqësorë privatë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 10

Juridiksioni territorial i Shërbimit Përmbaimit Gjyqësor Privat

Përmbauesi gjyqësor privat ose zyrat e përmbaimit privat ushtrojnë veprimtarinë përmbaimore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, këtij ligji dhe ligjeve të tjera për ekzekutimin e titujve ekzekutivë.

Neni 11

Detyrimi për të kryer ekzekutimin

Përmbauesi gjyqësor privat nuk mund të refuzojë një kërkesë për vënie në ekzekutim dhe/ose kryerjen e veprimeve të ekzekutimit, me përjashtim të shkaqeve që përbëjnë pengesë ligjore, në rastet kur pala kreditore:

- a) përfshihet në kategoritë përfituese të ndihmës ekonomike ose të pensionit të pleqërisë, apo është një person me aftësi të kufizuara;
- b) ka qenë përfituese e ndihmës juridike dytësore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;

c) është viktimë e veprës penale, së cilës i është njohur e drejta për shpërblimin e dëmit me vendim gjyqësor të formës së prerë;

ç) paraqet për ekzekutim një vendim përfundimtar të gjykatës administrative, që ka marrë formë të prerë, sipas legjislacionit në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative;

d) kërkon vënien në ekzekutim të vendimit për kundërvajtjen administrative, të nxjerrë në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

Neni 12

Papajtueshmëritë

1. Përmbaruesi gjyqësor privat nuk mund të ushtrojë njëkohësisht funksione publike dhe të praktikojë profesionin e avokatit, noterit apo ndërmjetësit si dhe çdo veprimtari që bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji ose janë të papajtueshme me ushtrimin e detyrës së përmbaruesit gjyqësor.

2. Përmbaruesi gjyqësor privat nuk mund të ushtrojë veprimtari tjetër politike, shtetërore ose profesionale që realizohet kundërt pagesës, me përjashtim të veprimtarisë akademike ose shkencore.

3. Një përmbarues gjyqësor privat apo një zyrë e përmbarimit privat nuk duhet të përdorë të njëjtën hapësirë zyre me një avokat, studio avokatie, noter ose ndonjë person tjetër fizik ose juridik, gjatë ushtrimit të funksionit të tyre.

4. Përmbaruesi gjyqësor privat nuk mund të angazhohet në veprimtari përmbarimore, e cila mund të çënojë paanshmërinë e tij.

Neni 13

Konflikti i interesit

1. Përmbaruesi gjyqësor privat është i detyruar të mos pranojë kërkesën për vënie në ekzekutim ose të heqë dorë nga ekzekutimi kur ky ka filluar, nëse ai ka marrë dijeni ose duhet të kishte marrë dijeni për ekzistencën e një shkakut, që tregon një konflikt interesi, kur:

a) ka një interes personal, të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me të apo të afërmit e tij deri në shkallën e dytë, në çështjen për të cilën kërkohet ose ka filluar ekzekutimi;

b) përmbaruesi gjyqësor privat është kujdestar apo përfaqësues i njëres prej palëve në proces ekzekutimi;

- c) ai vetë, bashkëshorti/ja ose të afërmit e tij deri në shkallën e dytë janë në konflikt gjyqësor, në marrëdhënie kredie ose huaje me njërin prej palëve në proces ekzekutimi;
 - ç) bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë përfaqësojnë në rolin e avokatit dhe/ose kanë kryer veprimtari në rolin e noterit me njërin prej palëve në proces ekzekutimi;
 - d) ekziston një arsye serioze dhe e mjaftueshme që tregon një situatë konflikti interesi.
2. Nëse rrethana të tilla vërtetohen ndërmjet ortakëve, aksionarëve apo administratorit të një zyre përmbarimi privat, secili përmbarues gjyqësor privat i kësaj zyre është i detyruar që të mos pranojë kërkesën për vënie në ekzekutim apo të heqë dorë nga ekzekutimi, kur ky ka filluar.

Neni 14

Përgjegjësitë e Ministrit

Ministri ushtron përgjegjësitë e mëposhtme:

- a) jep, pezullon ose heq licencën e ushtrimit të veprimtarisë përmbarimore të përmbaruesit gjyqësor privat;
- b) kontrollon, nëpërmjet strukturave përgjegjëse të ministrisë, zbatimin e këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, lidhur me veprimtarinë e përmbaruesve gjyqësorë privatë;
- c) miraton Kodin e Etikës së përmbaruesve gjyqësorë privatë;
- ç) fillon procedimin disiplinor ndaj përmbaruesve gjyqësorë privatë sipas parashikimeve të këtij ligji;
- d) miraton rregullat e funksionimit të komisionit vlerësues për provimin e kualifikimit të përmbaruesve gjyqësorë privatë sipas parashikimeve të këtij ligji;
- dh) miraton modelin e kontratës së shërbimit, që lidhet midis përmbaruesit gjyqësor privat dhe palës së interesuar pasi merret mendimi i Dhomës;
- e) përcakton, tarifat përkatëse për kryerjen e shërbimit të përmbarimit gjyqësor privat, në bashkëpunim me Ministrin përgjegjës për financat, pasi merret mendimi i Dhomës;
- ë) cakton një të deleguar në mbledhjet e Këshillit Drejtues të Dhomës pa të drejtë vote;
- f) organizon provimin e kualifikimit për përmbarues gjyqësor privat;
- g) miraton modelin e kontratës që lidhet midis përmbaruesit gjyqësor privat dhe palës së interesuar për njoftimin dhe mbledhjen e detyrimeve financiare me mirëkuptim;
- gj) miraton modelin e kontratës që lidhet midis përmbaruesit gjyqësor privat dhe palës së interesuar për kryerjen e konstatimeve të fakteve, sendeve dhe dukurive lehtësisht të verifikueshme, që nuk kërkojnë njohuri specifike teknike sipas legjislacionit në fuqi;
- h) miraton modelin e kontratës që lidhet midis përmbaruesit gjyqësor privat dhe palës së interesuar për shitjen e sendeve në ankand publik;

i) miraton rregulla të hollësishme për krijimin, mbajtjen dhe administrimin e arkivave bazuar në legjislacionin në fuqi, pasi merret mendimi i Dhomës.

KREU III

LICENCIMI DHE REGJISTRIMI

Neni 15

Organi licencues

1. Ministri është autoriteti shtetëror përgjegjës, i cili i jep licencën individuale për ushtrimin e veprimtarisë përmbartimore, individëve që kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre si përmbartues gjyqësorë privatë, në përputhje me rregullat dhe procedurat e parashikuara në këtë ligj.

2. Asnjë individ nuk mund të fitojë titullin dhe të ushtrojë funksionin e përmbartuesit gjyqësor privat, pa u pajisur më parë me licencën për ushtrimin e veprimtarisë përmbartimore, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 16

Kushtet për licencimin e përmbartuesit gjyqësor privat

Individi, që kërkon të licencohet si përmbartues gjyqësor privat, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të ketë përfunduar programin e ciklit të dytë të studimeve universitare për drejtësi brenda vendit, ose diplomë të njësuar me të, apo të ketë përfunduar studimet universitare për drejtësi jashtë vendit, të njohur dhe njësuar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë;

ç) të ketë përfunduar me sukses programin e detyrueshëm 1-vjeçar të trajnimit fillestar pranë Qendrës së Trajnimit;

d) të jetë në marrëdhënie pune me kohë të plotë me një përmbartues gjyqësor privat ose zyrë të përmbartimit privat, si ndihmës përmbartues për një periudhë jo më të vogël se 2 vjet, pas kryerjes së trajnimit të detyrueshëm fillestar;

dh) të ketë kaluar me sukses provimin e kualifikimit si përmbartues gjyqësor privat;

e) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë:

- i) për një vepër penale të kryer me dashje, për të cilën nuk është rehabilituar;
 - ii) për një vepër penale të kryer me pakujdesi, për të cilën nuk është rehabilituar dhe që cenon figurën dhe integritetin e profesionit të përmbarduesit gjyqësor;
 - iii) për një vepër penale të kryer me dashje, për të cilën është rehabilituar, kur vepra penale cenon figurën dhe integritetin e profesionit të përmbarduesit gjyqësor;
- ë) të mos jetë shkarkuar nga ushtrimi i detyrës ose funksionit publik, me vendim të organit kompetent, që ka marrë formë të prerë.

Neni 17

Qendra Kombëtare e Trajnimit të Përmbarduesve

1. Qendra e Trajnimit ngrihet pranë Dhomës dhe është institucioni përgjegjës për trajnimin fillestar dhe vazhdues të përmbarduesve gjyqësorë privat. Qendra e Trajnimit, financohet dhe administrohet nga Dhoma.

2. Qendra e Trajnimit ofron programet e trajnimit fillestar për kandidatët për përmbardues gjyqësor privat si dhe programet e trajnimit vazhdues për përmbarduesit gjyqësor privat. Qendra e Trajnimit mund të ofrojë edhe kurse trajnimi për juristët që synojnë njohuri profesionale, teorike dhe praktike në fushën e ekzekutimit të detyruar përmbardimor.

3. Tarifat e formimit fillestar dhe të formimit vazhdues pranë Qendrës së Trajnimit, miratohen nga Dhoma.

4. Dhoma mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me organet drejtuese të dhomave të tjera të profesioneve të lira dhe/ose me institucione të tjera të interesuara, lidhur me organizimin e programeve të përbashkëta të trajnimeve ose për trajnime specifike.

5. Rregulla të hollësishme mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Qendrës së Trajnimit, mënyrën e financimit si dhe përzgjedhjen dhe veprimtarinë e stafit akademik, përcaktohen në Rregulloren e Qendrës së Trajnimit, e cila miratohet nga Ministri me propozim të Dhomës.

Neni 18

Trajnimi fillestar

1. Dhoma kryen çdo vit analizë mbi nevojën e zhvillimit të provimit të pranimit në trajnimin fillestar, me synim për të garantuar për të paktën 3 vitet në vijim një numër të mjaftueshëm kandidatësh për plotësimin e vendeve vakante të përmbarduesve gjyqësorë privatë. Në rast se nga analiza konstatohet mundësia e krijimit të të paktën 7 vendeve vakante në 3 vitet e ardhshme, Ministri, pas marrjes së mendimit me shkrim nga Dhoma, përcakton me urdhër numrin e vendeve si kandidat përmbardues, që do të pranohen në programin e trajnimit fillestar.

2. Dhoma shpall në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, thirrjen për shprehjen e interesit për hyrjen në provimin e pranimit në trajnimin fillestar, e cila përmban afatin brenda të cilit duhet të dorëzohet shprehja e interesit, dokumentacionin bashkëlidhur me të, si dhe adresën postare dhe elektronike të dërgimit të tyre. Thirrja publikohet për të paktën dy javë rresht, në faqen zyrtare të Dhomës dhe Ministrisë.

3. Kandidatët për përmbarues gjyqësor privat që përmbushin kushtet e parashikuara në nenin 16, shkronjat “a”, “b”, “c”, “e”, dhe “ë” kanë të drejtë të marrin pjesë në provimin e pranimit në trajnimin fillestar. Kandidati që kalon me sukses provimin e pranimit në programin e trajnimit fillestar pranohet për të ndjekur programin e detyrueshëm 1-vjeçar për trajnimin fillestar pranë Qendrës së Trajnimit.

4. Programi i Detyrueshëm për Trajnimin Fillestar përcakton rregullat dhe kushtet për zhvillimin e provimit të pranimit, lëndët, metodat e trajnimit, modulet ose kurset e trajnimit, rregullat për kontrollin e njohurive në përfundim të trajnimit fillestar si dhe rregullat dhe kushtet për lëshimin e vërtetimit për përfundimin me sukses të programit të trajnimit fillestar.

5. Programi i Detyrueshëm për Trajnimin Fillestar miratohet nga Ministri, me propozim të Dhomës.

Neni 19

Ndihmës përmbaruesi

1. Kandidatët për përmbarues gjyqësor privat të cilët kanë kryer trajnimin fillestar dhe që përmbushin kushtet e parashikuara në nenin 16, shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “e” dhe “ë”, kanë të drejtë të regjistrohen pranë Ministrisë si ndihmës përmbarues.
2. Ministria, pasi verifikon nëse dokumentet e paraqitura nga kërkuesi janë në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara në këtë ligj, bën regjistrimin në regjistrin e parashikuar në nenin 23 të këtij ligji.
3. Ndihmës përmbaruesi kryhen veprimtarinë duke u punësuar pranë një përmbaruesi gjyqësor të licencuar ose një zyre të përmbarimit privat, që ushtron veprimtarinë në mënyrë aktive. Ndihmës përmbaruesi nuk mund të jetë bashkëshort ose i afërt deri në shkallë të dytë i përmbaruesit gjyqësor pranë të cilit punësohet.
4. Përmbaruesit gjyqësorë privat kanë të drejtë të pranojnë jo më shumë se një ndihmës përmbarues, ndërsa zyrat e përmbarimit privat mund të pranojnë jo më shumë se një ndihmës përmbarues për çdo përmbarues gjyqësor privat që vepron pranë zyrës.
5. Ndihmës përmbaruesi, me kërkesë të përmbaruesit gjyqësor privat, mbështet dhe asiston me aktivitetet administrative të veprimtarisë përmbarimore, por nuk mund të kryejë procedura që lidhen me ekzekutimin.
6. Ndihmës përmbaruesi e ushtron veprimtarinë vetëm pranë përmbaruesit gjyqësor ku është punësuar, me të cilin lidh një kontratë pune me kohë të plotë në përputhje me parashikimet e Kodit të Punës dhe legjislacionit në fuqi për sigurimet shoqërore.

7. Ndhmës përmbauesi, brenda 15 ditëve nga momenti i lidhjes së kontratës me përmbauesin gjyqësor, depoziton në Dhomë dhe në Ministri një kopje të kontratës dhe dokumentacionin ligjor të kërkuar.
8. Ndhmës përmbauesi mund të transferohet pranë një përmbauesi gjyqësor të ndryshëm nga ai ku është punësuar vetëm me pëlqimin e përmbauesve respektivë, pas njoftimit të Ministrit dhe të Dhomës. Transferimi shënohet në regjistër.
9. Puna e ndihmës përmbauesit vlerësohet nga përmbauesi gjyqësor privat përgjegjës për çdo vit kalendarik. Vlerësimi dorëzohet pranë Dhomës jo më vonë se data 31 janar e çdo viti. Dhoma përcakton rregulla më të hollësishme për kriteret, metodologjinë dhe nivelet e vlerësimit të kandidatit për përmbaues gjyqësor privat. Ndhmës përmbauesi ka detyrim të ndjekë programin e detyrueshëm të trajnimit vazhdues pranë Qendrës së Trajnimit.
10. Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrimin si ndihmës përmbaues përcaktohet me urdhër të Ministrit.

Neni 20

Provimi i kualifikimit

1. Provimi i kualifikimit për përmbaues gjyqësorë privatë planifikohet për zhvillim bazuar mbi kërkesat dhe nevojat publike për numrin e tyre, sipas parashikimeve të nenit 9 të këtij ligji, me urdhër të Ministrit.
2. Në rast krijimi vendi vakant për përmbaues gjyqësor privat, të gjithë ndihmës përmbauesit që përmbushin kushtet e parashikuara në nenin 16, shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “e” dhe “ë” kanë të drejtë t'i nënshtrohen provimit të kualifikimit për përmbaues gjyqësorë privatë.
3. Provimi i kualifikimit për përmbauesit gjyqësorë privatë zhvillohet përpara një komisioni me këtë përbërje:
 - a) një anëtar i caktuar nga Dhoma;
 - b) një anëtar i caktuar nga Ministria;
 - c) një anëtar i caktuar nga Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës.
4. Njoftimi për organizimin e provimit të kualifikimit të përmbauesve gjyqësorë privat, shpallet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare dhe publikohet, për së paku 15 ditë, në faqen zyrtare të Ministrisë dhe të Dhomës.
5. Provimi i kualifikimit përbëhet nga pjesa e kontrollit të njohurive me shkrim dhe pjesa e provimit me gojë, ku pjesa me shkrim përmban 75% të numrit total të pikëve. Kandidatët kanë të drejtë të hyjnë në pjesën e provimit me shkrim deri në 3 herë.
6. Provimi me gojë zhvillohet brenda një afati prej 4 javësh pas provimit përkatës me shkrim para Komisionit të Kualifikimit. Në provimin me gojë mund të kalojnë vetëm

personat që kanë marrë të paktën 60% të pikëve në provimin me shkrim. Provimet me gojë janë të hapura për publikun.

7. Anëtarët e Komisionit të Kualifikimit, pas përfundimit të provimit me gojë japin vlerësimin e tyre në lidhje me rezultatet për çdo individ në konsultime me dyer të mbyllura. Anëtarët e Komisionit janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e diskutimeve dhe të votimit.
8. Fitues është individi që ka mbledhur pikët më të larta në provimin e kualifikimit, me kusht që të ketë grumbulluar minimalisht 60 përqind të pikëve maksimale të parashikuara, deri në plotësimin e vendeve vakante sipas urdhërit të Ministrit, të parashikuar në pikën 1 e këtij neni.
9. Pas zhvillimit të provimit të kualifikimit, lista e fituesve shpallet publikisht dhe qëndron e afishuar për 15 ditë, në selinë e Ministrisë, Dhomës si edhe në faqet zyrtare të tyre.
10. Rregullat e hollësishme për funksionimin e Komisionit të Kualifikimit, zhvillimin e provimeve dhe procedurën e vlerësimit përcaktohen me urdhër të Ministrit, pasi të jetë marrë mendimi i Dhomës.

Neni 21

Betimi i përmbauesit gjyqësor privat, regjistrimi dhe fillimi i veprimtarisë

1. Ministri licencon si përmbaues gjyqësor privat, individin që përmbush kushtet e nenit 16 të këtij ligji dhe që është shpallur fitues i provimit të kualifikimit në përputhje me pikën 8 të nenit 20 të këtij ligji.
2. Përmbauesi gjyqësor privat bën betimin përpara Ministrit, ose një përfaqësuesi të autorizuar prej tij, sipas deklaratës solemne:
“Beto hem se detyrat e përmbauesit gjyqësor privat do t'i kryej në përputhje me ligjin, duke i qëndruar besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, do të ruaj sekretin profesional dhe gjatë veprimtarisë sime do të udhëhiqem nga parimet e profesionalizmit, paanësisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut”.
Ministri ose i autorizuari prej tij, menjëherë pasi është kryer betimi, dorëzon licencën individuale të ushtrimit të veprimtarisë përmbaimore te përmbauesi gjyqësor privat.
3. Vetëm përmbauesi gjyqësor privat i licencuar sipas pikës 1 dhe që ka bërë betimin sipas pikës 2, të këtij neni, mund të bëjë kërkesë që të regjistrohet në “Regjistrin e përmbauesve gjyqësorë privatë”. Në momentin e regjistrimit në Regjistër, përmbauesi gjyqësor privat fillon ushtrimin e veprimtarisë përmbaimore.
4. Përpara regjistrimit në Regjistër dhe fillimit të veprimtarisë përmbaimore, përmbauesi gjyqësor privat:
 - a) regjistrohet në regjistrin tregtar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për regjistrimin e biznesit, dhe pajiset me Numrin Unik të Identifikimit të Subjektit (NUIS);

- b) lidh marrëveshje për sigurimin e përgjegjësisë profesionale për dëmet që mund t'i shkaktohen personave të tretë gjatë veprimtarisë përmbarimore;
- c) lidh marrëveshje për sigurimin e pasurive ose sendeve të marra për depozitim, nga risku i dëmtimit, shkatërrimit ose humbjes së tyre;
- ç) hap llogarinë e veçantë bankare sipas parashikimeve të këtij ligji;
- d) siguron hapësirë të përshtatshme për kryerjen e veprimtarisë përmbarimore;
- dh) siguron pajisjet e nevojshme për kryerjen e veprimtarisë përmbarimore;
- e) bën kërkesë për sigurimin e vulës personale dhe plumbit të sekuestrimit përmbarimor.

Kushtet e minimale teknike që kanë të bëjnë me infrastrukturën për ushtrimin e veprimtarisë, përcaktohen me urdhër të Ministrit, pas propozimit të Dhomës, si pjesë e standardeve minimale të ushtrimit të profesionit.

5. Nëse përmbaruesi gjyqësor privat i licencuar nuk paraqet kërkesë për regjistrim në “Regjistrin e përmbaruesve gjyqësorë privatë”, brenda 30 ditëve nga licencimi, Ministri vendos heqjen e licencës dhe njofton brenda tre ditëve për kryerjen e betimit individin e renditur më lart pas personit që u licencua dhe nuk paraqiti kërkesë për regjistrim.
6. Përmbaruesi gjyqësor privat, i licencuar nga Ministri, për arsye të forcës madhore mund të kërkojë zgjatjen e afatit të regjistrimit në regjistrin e Përmbaruesve Gjyqësor Privat deri në tre muaj. Ministri mund të vendosë pranimin ose refuzimin e kërkesës së përmbaruesit gjyqësor privat të licencuar. Me kalimin e afatit tremujor, nëse përmbaruesi gjyqësor privat nuk paraqet kërkesën për regjistrim, zbatohen parashikimet e pikës 5 të këtij neni.
7. Përmbaruesi gjyqësor privat konsiderohet se nuk është regjistruar dhe nuk ka filluar veprimtarinë përmbarimore nëse:
 - a) brenda afatit të parashikuar në pikën 5 të këtij neni, nuk paraqet dëshmi për plotësimin e kushteve të parashikuara për regjistrim dhe fillimin e aktivitetit, ose
 - b) nuk fillon ushtrimin e veprimtarisë në momentin e regjistrimit, ose nuk regjistron në regjistrin e Ministrisë asnjë kërkesë për vënie në ekzekutim për një periudhë 3 mujore.

Neni 22

Programi i Detyrueshëm i Trajnimit Vazhdues

1. Përmbaruesit dhe ndihmës përmbaruesit ndjekin Programin e Detyrueshëm të Trajnimit Vazhdues pranë Qendrës së Trajnimit.
2. Programi i Detyrueshëm i Trajnimit të Vazhdues përcakton metodat e trajnimit, programin e saktë të trajnimit dhe modulet e trajnimit, rregullat dhe kushtet për lëshimin e çertifikatave të pjesëmarrjes dhe rregullat të tjera të hollësishme për trajnimin vazhdues të detyrueshëm.

3. Programi i Detyrueshëm i Trajnimit Vazhdues miratohet nga Ministri me propozim të Dhomës.

Neni 23

Regjistri i Përmbauesve Gjyqësorë Privatë dhe Regjistri Unik i të dhënave për zyrat përmbaimore dhe përmbauesit gjyqësorë privatë

1. Regjistri i Përmbauesve Gjyqësorë Privatë krijohet pranë Ministrisë. Ky Regjistër ruhet, mirëmbahet dhe përditësohet në format të integruar manual dhe elektronik nga strukturat përgjegjëse të Ministrisë. Ky Regjistër përmban të dhënat publike si më poshtë vijon:

- a) identiteti;
- b) vendbanimi;
- c) numri i licencës;
- ç) data e fillimit të veprimtarisë përmbaimore;
- d) Numri Unik të Identifikimit të Subjektit (NUIS);
- d) adresa e vendit, ku zhvillon veprimtarinë përmbaimore.

2. Regjistri Unik i të Dhënave për Zyrat e Përmbaimit Privat dhe Përmbauesit Gjyqësorë Privatë krijohet, mirëmbahet dhe përditësohet nga Ministria. Regjistri unik ndahet në dy pjesë. Në pjesën e parë regjistrohen të dhënat e përmbauesve gjyqësorë privatë si vijon:

- a) identiteti (emër, mbiemër, atësi, datëlindje, numri personal i identifikimit dhe fotografi);
- b) adresa e vendbanimit;
- c) numri i certifikatës së aftësisë profesionale ose licencës sipas rastit, data, lloji i certifikimit/licencimit;
- ç) numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS);
- d) data e fillimit të veprimtarisë përmbaimore;
- dh) adresa e vendit ku zhvillon veprimtarinë përmbaimore;
- e) adresa elektronike zyrtare, numri i kontaktit, çelësi publik elektronik;
- ë) të dhënat për pezullimin e certifikatës/licencës;
- f) të dhëna mbi masa disiplinore nëse ka të tilla;
- g) të dhënat e policës së sigurimit të veprimtarisë profesionale;
- gj) të dhëna në lidhje me leje vjetore, studimore, mjekësore dhe pezullimit të përkohshëm nga veprimtaria përmbaimore;
- h) të dhëna rreth arsimit universitar, si dhe certifikimit të njohurive të gjuhës së huaj nëse ka;
- i) numri i llogarisë së veçantë bankare për procedurat e ekzekutimit.

3. Në pjesën e dytë regjistrohen të dhënat e zyrave të përmbaimit privat, si vijon:

- a) emri i zyrës së përmbaimit privat dhe të dhënat për ortakët/aksionarët dhe administratorin (emri, mbiemri, datëlindja, numri personal i identifikimit);
- b) Numrin Unik të Identifikimit të Subjektit (NUIS) dhe datën e regjistrimit të aktivitetit;
- c) adresën e selisë së zhvillimit të aktivitetit, adresën zyrtare elektronike, faqen zyrtare të internetit;
- ç) të dhënat e personave të punësuar në zyrën e përmbaimit privat, sipas shkronjës “a)” të pikës 2 të këtij neni.

4. Përmbauesit gjyqësorë privatë dhe zyrtat e përmbaimit privat, deklarojnë regjistrimin e të gjitha të dhënave të parashikuara në pikën 2, të këtij neni në mënyrë të plotë dhe detyrohen t'i pasqyrojnë të dhënat sipas shkronjave “a”, “b”, “ç”, “dh”, “e”, “g”, “gj” dhe “i” të pikës 2 të këtij neni për përmbauesit gjyqësorë privatë dhe të dhënat e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, për zyrtat e përmbaimit privat duke i deklaruar pranë Ministrisë jo më vonë se 10 ditë nga data e ndryshimit të tyre.

5. Regjistri i Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, sipas pikës 1 këtij neni qëndron në format elektronik të integruar dhe përditësohet me të njëjtat të dhëna në faqet zyrtare të Ministrisë dhe Dhomës.

6. Regjistri Unik i të Dhënave për Zyrtat e Përmbaimit Privat dhe Përmbauesit Gjyqësorë Privatë qëndron në Ministri dhe informacioni mbi të dhënat, shënimet, ndryshimet dhe faktet e treguara në të, autorizohen vetëm nga Ministri.

7. Pranë Ministrisë krijohet regjistri i ndihmës përmbauesve i cili përmban të dhëna në lidhje me:

- a) identitetin (emër, mbiemër, atësi, datëlindje, vendlindje, vendbanim dhe numër personal të identifikimit);
- b) datën e fillimit të marrëdhënies së punës;
- c) kontratën e punës;
- ç) adresën e vendit, ku zhvillon aktivitetin;
- d) vlerësimet nga përmbauesit gjyqësor privat ku është punësuar.

8. Format i Regjistrave të parashikuar në pikat 1, 2, 3 dhe 7 të këtij neni, mënyra e mbajtjes dhe përditësimit të të dhënave në to, përcaktohet me urdhër të Ministrisë pas marrjes së mendimit të Dhomës.

9. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale që ndodhen në regjistrat e Ministrisë bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 24

Sistemi i menaxhimit elektronik të çështjeve të përmbaimit gjyqësor

1. Pranë Ministrisë funksionon regjistri qendror i kërkesave për vënie në ekzekutim të urdhrave të ekzekutimit si bazë të dhënash shtetërore, sipas legjislacionit në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore.

2. Regjistri qendror i kërkesave për vënie në ekzekutim të urdhrave të ekzekutimit, mbahet në format elektronik sipas sistemit të menaxhimit elektronik të çështjeve të përmbaimit gjyqësor.

3. Mënyra e mbajtjes së regjistrit qendror të kërkesave për vënie në ekzekutim të urdhrave të ekzekutimit dhe ndërveprimi me bazat e tjera të të dhënave shtetërore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Sistemi i Administrimit të të Dhënave dhe Informacionit të Përmbaruesit që funksionon pranë Dhomës, ndërvepron me regjistrin qendror të kërkesave për vënie në ekzekutim të urdhrave të ekzekutimit dhe me bazat e tjera të të dhënave shtetërore, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Neni 25

Punësimi i personave të palicencuar

1. Zyrat e përmbarimit privat dhe përmbaruesit gjyqësorë privatë nuk mund të caktojnë apo autorizojnë asnjë individ të palicencuar apo të çregjistruar nga regjistri i përmbaruesve gjyqësorë privatë që të veprojnë në emër të tyre gjatë një procedure ekzekutimi.

2. Të punësuarit pranë një përmbaruesi gjyqësor privat ose një zyre të përmbarimit privat mund të kryejnë veprime procedurale me pasoja për palët që lidhen me procedurat përmbarimore, vetëm nëse janë të licencuar dhe të regjistruar si përmbarues gjyqësor privat sipas parashikimeve të këtij ligji.

KREU IV

PEZULLIMI, HEQJA E LICENCËS DHE ÇREGJISTRIMI I PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

Neni 26

Pezullimi i përkohshëm i përmbaruesit me kërkesë të tij

1. Përmbaruesi ka të drejtë të ndërpresë ushtrimin e profesionit dhe të kalojë në statusin pasiv për arsyet e mëposhtme:

- a) për shkaqe shëndetësore, të provuara nga vërtetimi i gjendjes shëndetësore, sipas legjislacionit në fuqi;
- b) përkujdesjes për fëmijën e tij të mitur derisa fëmija të mbushë moshën 3-vjeçare;
- c) zgjedhjes ose emërimit në një funksion publik.

Për rastet e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike, pezullimi zgjat për një periudhë deri në 3 vjet. Në rastin e zgjedhjes ose emërimit në një funksion publik, periudha e pezullimit është sa kohëzgjatja e funksionit publik.

2. Kërkesa e arsyetuar për pezullimin e përkohshëm të licencës i drejtohet Ministrit dhe Kryetarit të Dhomës dhe përmban kohëzgjatjen e periudhës së pezullimit.
3. Ministri vendos për pranimin ose refuzimin e argumentuar të kërkesës për pezullimin e përkohshëm të licencës së përmbauesit gjyqësor privat, duke marrë në konsideratë edhe mendimin e Dhomës.
4. Përmbauesi gjyqësor privat që ka bërë kërkesë, për arsye të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, mund të propozojë caktimin e një përmbauesi gjyqësor privat tjetër si zëvendësues i tij. Në rast se përmbauesi gjyqësor privat nuk propozon përmbauesin gjyqësor privat zëvendësues, Ministri e cakton atë në përputhje me parashikimet e nenit 48 të këtij ligji.
5. Vendimi i Ministrit për pezullimin e përkohshëm të licencës së një përmbauesi dhe për caktimin e një përmbauesi gjyqësor privat zëvendësues publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë dhe të Dhomës.
6. Përmbauesi mund të bëjë kërkesë tjetër për pezullim të përkohshëm, por jo më parë se 4 vjet nga data e rikthimit në detyrë, me përjashtim të rastit të parashikuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni, ose kur pezullimi kërkohet për një fëmijë tjetër, sipas parashikimeve të shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni.
7. Kur me kalimin e 2 muajve nga mbarimi i detyrës, përmbauesi gjyqësor privat i pezulluar nuk paraqet kërkesë për rifillimin e veprimtarisë, ai çregjistrohet nga regjistri i përmbauesve gjyqësor privat.
8. Rregulla të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shqyrtimit të kërkesës për pezullimin e përkohshëm përcaktohen me udhëzim të Ministrit.

Neni 27

Pezullimi nga detyra për shkaqe të tjera

1. Përmbauesi gjyqësor privat mund të pezullohet përkohësisht nga detyra nga Ministri kur:
 - a) ndaj tij është caktuar masa e sigurimit personal me arrest, për vepra penale që lidhen me “shpërdorimin e detyrës” dhe/ose me pengimin e ekzekutimit;
 - b) ndaj tij ka filluar një procedurë për çregjistrim nga regjistri i përmbauesive gjyqësor privat kur ka dyshime të arsyeshme se licencimi është bërë në kundërshtim me kushtet e parashikuara në nenin 16 të këtij ligji;
 - c) ndaj tij ka filluar një procedurë për heqjen e zotësisë juridike për të vepruar;
 - ç) i kufizohet zotësia juridike për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - d) nuk mund të kërkojë pezullim vullnetar sipas nenit 26 të këtij ligji, ose zgjatje të periudhës së pezullimit vullnetar, për shkak të një sëmundjeje ose paaftësie fizike apo mendore;
 - dh) nuk paguan, kuotën vjetore të anëtarësisë, si dhe tarifën në funksion të trajnimit vazhdues të detyrueshëm deri në fillim të vitit pasardhës financiar.

2. Kundër vendimit të Ministrit përmbaruesi gjyqësor privat mund të bëjë ankim në gjykatën administrative kompetente, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

Neni 28

Çregjistrimi nga regjistri i profesionit të përmbaruesit gjyqësor privat

Përmbaruesit gjyqësor i hiqet licenca dhe çregjistrohet nga regjistri në rastet kur:

- a) heq dorë me kërkesën e tij nga ushtrimi i profesionit të përmbaruesit gjyqësor privat;
- b) humbet zotësinë juridike për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- c) dënohet penalisht me një vendim të formës së prerë të gjykatës, për kryerjen e një vepre penale sipas përcaktimeve të nenit 16, shkronja “e” të këtij ligji;
- ç) nuk bën betimin, nuk paraqet kërkesë për fillimin e veprimtarisë përmbarimore ose nuk plotëson kushtet për fillimin e kësaj veprimtarie sipas parashikimeve të këtij ligji.
- d) ndaj tij jepet masa disiplinore e heqjes së licencës;
- dh) nuk paraqet kërkesë për rifillimin e veprimtarisë, në rast se licenca është pezulluar;
- e) mbush moshën e pensionit sipas legjislacionit në fuqi;
- ë) vërtetohet se nuk kanë ekzistuar ose nuk ekzistojnë kushtet për licencim si përmbarues gjyqësor privat të parashikuara në nenin 16 të këtij ligji;
- f) konstatohet se nuk ka kryer veprimtari përmbarimore si përmbarues gjyqësor privat, pa shkaqe të justifikuara ligjore, për më shumë se 3 (tre) muaj.

KREU V

ORGANET DREJTUESE DHE KOMPETENCAT E DHOMËS KOMBËTARE TË PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

Neni 29

Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë

1. Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë përfaqëson bashkimin e detyrueshëm të të gjithë përmbaruesve gjyqësorë privatë të licencuar në Republikën e Shqipërisë. Çdo përmbarues gjyqësor privat i licencuar dhe regjistruar në Regjistrin e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë është detyrimisht anëtar i Dhomës.

2. Dhoma përgjigjet për organizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e ushtrimit të profesionit të përmbauesit gjyqësor privat në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij ligji.
3. Dhoma është person juridik, me status të krijuar me ligj të veçantë dhe që ushtron veprimtarinë e saj në mënyrë të pavaruar nga shteti. Ajo fiton personalitet juridik për shkak të ligjit.
4. Dhoma ka të drejtë të krijojë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme me burime të ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilat regjistrohen dhe administrohen prej saj, sipas legjislacionit në fuqi.
5. Dhoma ushtron kompetencat e mëposhtme:
 - a) nxjerr udhëzues lidhur me funksionimin e veprimtarisë së përmbauesve gjyqësorë privatë;
 - b) ushtron funksionet nëpërmjet organeve drejtuese të saj dhe stafit administrativ të caktuar për këtë qëllim;
 - c) administron Qendrën Kombëtare të Trajnimit të Përmbauesve;
 - ç) përfaqëson nëpërmjet Kryetarit, Shërbimin Përmbauesor Gjyqësor Privat në marrëdhënie me Ministrinë, organet e tjera të administratës shtetërore, organizatat ndërkombëtare dhe palët e treta.
6. Rregulla të hollësishme lidhur me organizimin dhe funksionimin e Dhomës përcaktohen në statutin e saj.

Neni 30

Organet drejtuese të Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë

Organet drejtuese të Dhomës janë: Asambleja e Përgjithshme, Këshilli Drejtues dhe Kryetari i Dhomës.

Neni 31

Asambleja e Përgjithshme

1. Organi më i lartë i përfaqësimit dhe vendimmarrjes së Dhomës është Asambleja e Përgjithshme.
2. Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga të gjithë përmbauesit gjyqësorë privatë të licencuar dhe të regjistruar në status aktiv pranë Regjistrat të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë.
3. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme organizohen kur janë të pranishëm jo më pak se 1/2 e përmbauesve gjyqësorë privatë, të cilët nuk janë të pezulluar dhe/ose që nuk kanë pengesa sipas parashikimeve në Statutin e Dhomës.

4. Rregullat të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të Asamblesë së Përgjithshme përcaktohen në Statutin e Dhomës.

Neni 32

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme ushtron këto kompetenca:

- a) zgjedh dhe shkarkon sipas parashikimeve të statutit, organet drejtuese të Dhomës si dhe nënkryetarin dhe sekretarin e përgjithshëm;
- b) cakton kuotat e anëtarësisë, që duhet të derdhin përmbaruesit gjyqësorë privatë në llogarinë e Dhomës;
- c) miraton çdo vit buxhetin dhe pasqyrat financiare të Dhomës;
- ç) miraton Statutin e ushtrimit të veprimtarisë së përmbaruesit gjyqësor privat;
- d) miraton rregulloren e organizimit të mbledhjeve dhe rregulloren e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Drejtues;
- dh) miraton Statutin e Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë;
- e) propozon rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Trajnimit;
- ë) miraton çdo akt tjetër të nevojshëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë së Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Privat;
- f) vendos për politikat e përgjithshme të Dhomës.

2. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme merren me shumicë votash. Miratimi dhe ndryshimi i Statutit të Dhomës bëhet me votat e shumicës së gjithë anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 33

Këshilli Drejtues

Këshilli Drejtues i Dhomës përbëhet nga 7 përfaqësues të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 34

Kompetencat e Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues ushtron këto kompetenca:

- a) harton dhe propozon Statutin e Dhomës;

- b) harton dhe propozon programin e detyrueshëm për trajnimin fillestar të kandidatëve për përmbaues gjyqësor privat sipas parashikimeve të këtij ligji;
- c) harton dhe propozon programin e detyrueshëm për trajnimin vazhdues të përmbaues gjyqësor privat sipas parashikimeve të këtij ligji;
- ç) harton dhe i paraqet Asamblesë së Përgjithshme rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Trajnimit;
- d) kontrollon respektimin e kushteve ligjore për organizimin dhe kryerjen e funksioneve nga përmbauesit gjyqësorë privatë të përcaktuara në këtë ligj dhe në statut;
- dh) kujdeset për funksionimin normal të përmbauesve gjyqësorë privatë ose zyrave të përmbaimit privat;
- e) jep mendime, kur i kërkohet, për projektligje dhe projektregullore, që kanë të bëjnë me profesionin e përmbauesit gjyqësor privat;
- ë) miraton rregulloren për trajtimin e ankesave dhe për çdo çështje në kompetencë të tij;
- f) bashkërendon dhe përkrah nismat, që kanë si qëllim përmirësimin dhe ngritjen profesionale;
- g) thërret mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme;
- gj) bashkëpunon me strukturat drejtuese të Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë dhe Dhomës Kombëtare të Notarisë për probleme, që kanë të bëjnë me çështjet e ekzekutimit;
- h) miraton formën e raportit manual dhe elektronik statistikor që përmbauesi gjyqësor privat paraqet për veprimtarinë e tij;
- i) propozon modulën e rregullave të veçanta për detyrat që mundet të kryejnë ndihmëspërmbauesit;
- j) siguron zbatimin e kriterëve profesionale dhe etike, me të cilat duhet të veprojnë përmbauesit gjyqësorë privatë, gjatë ushtrimit të funksionit të tyre;
- k) nxjerr udhëzues lidhur me funksionimin e veprimtarisë së përmbauesve gjyqësorë privatë;
- l) mbikëqyr ushtrimin e profesionit të përmbauesit gjyqësor privat sipas këtij ligji;
- ll) siguron mirëorganizimin e mbikëqyrjes mbi profesionin dhe zbatimin e standardeve profesionale sipas parashikimeve të këtij ligji;
- m) miraton listën e përmbauesve gjyqësorë privat për të ushtruar veprimtarinë e përmbauesit gjyqësor privat zëvendësues sipas parashikimeve të këtij ligji;
- n) harton modelin e kontratës së shërbimit, që lidhet midis përmbauesit gjyqësor privat dhe palës së interesuar, përpara fillimit të procedurave të ekzekutimit;
- nj) harton buxhetin dhe pasqyrat financiare dhe i paraqet për miratim pranë Asamblesë së Përgjithshme;
- o) administron asetet dhe fondet e Dhomës.

2. Mbledhjet e Këshillit Drejtues organizohen kur janë të pranishëm jo më pak se gjysma e anëtarëve. Vendimet e Këshillit merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Votimi në Këshill bëhet në mënyrë të hapur. Çdo anëtar i Këshillit ka të drejtën e një votë.

3. Rregulla të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Drejtues përcaktohen në Statutin e Dhomës.

Neni 35

Kryetari i dhomës

1. Kryetari është autoriteti më i lartë përfaqësues i Dhomës në marrëdhëniet me të tretët brenda apo jashtë vendit.

2. Kryetari zgjidhet për një mandat 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë.

3. Kryetari drejton mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme dhe të Këshillit Drejtues të Dhomës.

4. Kryetari ushtron funksionin e tij sipas këtij ligji, Statutit të Dhomës, si dhe kryen veprime të caktuara dhe të autorizuara nga Asambleja e Përgjithshme ose Këshilli Drejtues i Dhomës. Në rastet e pamundësisë së ushtrimit të funksioneve të tij, detyrat e tij kryen nga Nënkryetari, ndërsa në rast të pamundësisë së Nënkryetarit, nga Kryetari i Këshillit Drejtues.

5. Rregulla të hollësishme mbi mënyrën e zgjedhjes, funksionimit dhe ushtrimit të kompetencave të Kryetarit përcaktohen në Statutin e Dhomës.

KREU VI

TE DREJTAT, DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE MBROJTJA E VEÇANTË E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË TË LICENCUAR

Neni 36

Të drejtat e përmbaruesit gjyqësor privat

1. Përmbaruesi gjyqësor privat ka të drejtat e mëposhtme:

a) të pranojë lirisht kërkesat e subjekteve fizike apo juridike për ekzekutimin e titujve ekzekutivë, me përjashtim të rastit kur konstaton se është në situatën e konfliktit të interesit;

b) të pranojë lirisht kërkesat e subjekteve fizike apo juridike për njoftimin e akteve gjyqësore dhe dokumenteve zyrtare sipas parashikimeve të legjislacionit procedural;

- c) të pranojë lirisht kërkesat e subjekteve të interesuara për njoftimin apo kryerjen e mbledhjes së detyrimeve financiare me mirëkuptim;
- ç) të pranojë lirisht kërkesat e subjekteve të interesuara për kryerjen e konstatimeve të fakteve, sendeve dhe dukurive lehtësisht të verifikueshme, që nuk kërkojnë njohuri specifike teknike, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) të pranojë lirisht kërkesat e subjekteve të interesuara për kryerjen e shitjes së sendeve në ankand publik;
- dh) të përfitojë një tarifë fikse dhe tarifë suksesi në referim të kontratës së shërbimit ose marrëveshjes me palën kreditore në përputhje me parashikimet e këtij ligji;
- e) të kërkojë, kur e konsideron të nevojshme për veprimtarinë e tij procedurale, çdo informacion, që ka të bëjë me gjendjen pasurore të debitorit apo vendndodhjen e tij, të nevojshëm për procedurat e ekzekutimit, nga institucione shtetërore, persona juridikë apo fizikë, në përputhje me ligjin;
- ë) të ketë mbështetjen e Policisë së Shtetit, inspektoratit ndërtimor pranë pushtetit vendor dhe Inspektoratit Kombëtar përkatës, kur e çmon të domosdoshme, gjatë procedurave të ekzekutimit;
- f) të zgjidhë në mënyrë të njëanshme kontratën e lidhur me palën kreditore, kur kjo e fundit nuk përmbush detyrimet e veta;
- g) të aplikojë sanksionet e parashikuara në ligj, ndaj subjekteve fizike apo juridike, që pengojnë në mënyrë të paligjshme procedurën e ekzekutimit, në përputhje me nenin 53 të këtij ligji.

2. Tarifat për veprimtaritë dytësore të përmbauesit gjyqësor privat të parashikuara nga shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d” të pikës 1 këtij neni përcaktohen me udhëzim të Ministrit, me propozim të Dhomës.

Neni 37

Detyrat e përmbauesit gjyqësor privat

Përmbauesi gjyqësor privat ka këto detyra:

- a) të veprojë me ndershmëri, paanësi, profesionalizëm dhe kurdoherë në interes të palës kërkuese, pa cenuar në mënyrë të paligjshme të drejtat dhe interesat e palës tjetër;
- b) të zbatojë me përpikëri dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore;
- c) të kryejë për subjektet fizike ose juridike veprimet e nevojshme, që synojnë realizimin e së drejtës së tyre dhe mbrojtjen e interesave të tyre të ligjshëm;

- ç) të informojë për çdo veprim procedural palët në proces ekzekutimi, si dhe të japë sqarimet e nevojshme për veprimet e kryera;
- d) të këshillojë palën kreditore për pasojat juridike, që rrjedhin nga veprimet procedurale, me qëllim që të mos dëmtohen interesat e tyre;
- dh) të ruajë sekretin profesional dhe të mos zbulojë të dhëna, që i kanë mësuar gjatë veprimtarisë së tyre profesionale ose nga dokumentet, që i janë vënë në dispozicion nga palët në proces ekzekutimi, përveç kur dhënia e këtij informacioni është detyrim ligjor;
- e) të sigurojë veprimtarinë e tij profesionale pranë një shoqërie sigurimi;
- ë) të mbajë regjistrin standard të kryerjes së veprimtarisë përmbartimore, si dhe të përmbushë detyrimin e trajnimit vazhdues sipas parashikimeve të këtij ligji;
- f) të derdhë në mënyrë të rregullt detyrimet tatimore dhe profesionale;
- g) të marrë masat dhe veprimet e nevojshme për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, në respekt të dinjitetit njerëzor, duke vënë në balancë nevojat e debitorëve dhe interesat e kreditorëve;
- gj) të respektojë “Kodin e Etikës së Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë”, standardet profesionale dhe “Statutin e ushtrimit të veprimtarisë së përmbartuesit gjyqësor privat”;
- h) të mbajë të ekspozuar në mënyrë të dukshme dokumentin e identifikimit si përmbartues gjyqësor privat kur kryen veprime procedurale përmbartimore dhe/ose paraqitet përpara palëve të interesuara në lidhje me një procedurë përmbartimore;
- i) të mbajë adresë zyrtare elektronike sipas rregullave të përcaktuara me urdhër të Ministrit.

Neni 38

Praktika të ndaluara të përmbartuesit gjyqësor privat

1. Përmbartuesi gjyqësor privat gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, nuk duhet të kryejë veprime që cenojnë apo abuzojnë me subjektet, që u nënshtrohen procedurave të ekzekutimit.
2. Ndalohet veçanërisht kryerja e veprimtarive të mëposhtme:
 - a) përdorimi i paligjshëm i forcës ndaj subjekteve fizike, që i nënshtrohen ekzekutimit të detyruar apo pasurisë së tyre;
 - b) kërcënimi fizik apo presioni psikologjik ndaj subjektit, palë në procedurë ekzekutimi;
 - c) përdorimi i fjalëve të pahijshme, që cenojnë reputacionin apo dinjitetin e subjekteve, që i nënshtrohen ekzekutimit të detyruar;
 - ç) angazhimi në ndonjë praktikë të ndaluar, ose përdorimi i ndonjë metode të pandershme në mbledhjen e detyrimeve, në kundërshtim me dispozitat ligjore;

d) çdo veprim tjetër me karakter mashtrues, i cili do të komprometonte rëndë besimin e palëve dhe integritetin moral të përmbauesit gjyqësor privat;

dh) angazhimi nga përmbauesi gjyqësor privat, i personave të tjerë të palicencuar dhe të cilët nuk parashikohen nga ky ligj për kryerjen e veprimtarisë përmbaimore.

Neni 39

Mbrojtja e veçantë e përmbauesit gjyqësor privat

Kur përmbauesi gjyqësor privat, gjatë ushtrimit të detyrës së tij ose për shkak të saj i rrezikohet jeta, familja apo prona, shteti i garanton mbrojtje të veçantë. Kushtet dhe mënyra e përfitimit të kësaj mbrojtjeje përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 40

Publiciteti i veprimtarisë

Përmbauesi gjyqësor privat mund të reklamojë publikisht veprimtarinë e tij, por pa cënuar konkurrencën e ndershme dhe praktikën e ligjshme tregtare.

Neni 41

Konfidencialiteti

Përmbauesi gjyqësor privat, i cili merr informacionet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, ruan konfidencialitetin e këtyre të dhënave dhe nuk duhet t'ua japë këto informacione të tretëve përveç:

- a) organeve të rendit publik, prokurorisë ose gjykatës;
- b) Dhomës, vetëm për efekt të ushtrimit të kompetencave të parashikuara nga ky ligj;
- c) strukturave të tjera shtetërore, lidhur me çështjet pasurore të debitorëve;
- ç) përmbauesve të tjerë, vetëm nëse informacioni është i nevojshëm për procedurat e ekzekutimit;
- d) kreditorit, i cili ka depozituar për ekzekutim një titull ekzekutiv, në rastet kur nuk është njohur rregullisht me këtë informacion;
- dh) kur personi, për të cilin kërkohet informacioni, jep pëlqimin.

Neni 42

Llogaria bankare e përmbauesit gjyqësor privat

1. Përmbauesi gjyqësor privat, me fillimin e aktivitetit, duhet të hapë një llogari bankare të veçantë në emrin e tij, për t'u përdorur ekskluzivisht për depozitimin e vlerave monetare të

ardhura nga procedura përbarimore dhe nga mbledhja e detyrimeve financiare me mirëkuptim për palët e treta.

2. Përmbaruesi gjyqësor privat mund të mbajë veçmas, me qëllim ushtrimin e veprimtarisë profesionale, një llogari bankare për administrimin e aktivitetit tregtar si person fizik ose juridik si dhe shpërblimin dhe pagimin e shpenzimeve për veprimtaritë dytësore të parashikuara në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji.

3. Llogaria bankare e veçantë e përmbaruesit gjyqësor privat përdoret vetëm për mbajtur, transferuar dhe kryer pagesa që realizojnë qarkullimin e vlerave monetare me të cilat do të paguhen palët kreditore dhe shumat e bartura në këtë llogari, do të shfrytëzohen ekskluzivisht për përmbushjen e interesave të tyre në procesin përbarimor.

4. Llogaria bankare e veçantë për procedurat e ekzekutimit, shënohet në çdo akt të veprimit procedural dhe deklarohet në fillim të ushtrimit të veprimtarisë sipas kërkesave të parashikuara në këtë ligji.

5. Llogaria bankare e veçantë administrohet dhe disponohet vetëm nga përmbaruesi gjyqësor privat. Nëse një ose disa përmbarues gjyqësorë privatë organizohen në zyrë të përbarimit privat, çdo përmbarues gjyqësor administron dhe disponon llogarinë e veçantë në emër të tij.

6. Përmbaruesi gjyqësor transferon shumat nga llogaria bankare e veçantë, për në llogarinë e kreditorit, brenda ditës së dhjetë të vijimit të punës, pas kryerjes së procedurës së ekzekutimit, kur janë përfituar shuma prej procesit përbarimor dhe/ose prej sekuestrimit të llogarisë së debitorit apo palëve të lidhura me të.

7. Nëse detyrimi në të holla nuk është paguar në llogarinë e veçantë për procedurat e ekzekutimit, por në një llogari tjetër e cila është në emër të përmbaruesit gjyqësor, përmbaruesi gjyqësor privat transferon tek debitori këtë shumë brenda dhjetë ditëve të marrjes dijeni dhe nëse debitori, për çfarëdo arsye nuk arrin të kryejë pagesën nga llogaria tjetër, atëherë e paguan detyrimin nga fondet e tij.

Nëse në llogarinë e veçantë kanë kaluar gabimisht të holla që nuk lidhen me veprimin përmbarues, përmbaruesi gjyqësor privat i transferon mbrapsht pagesit të njëjtën shumë brenda dhjetë ditëve të marrjes dijeni.

8. Detyrimi monetar që derdhet në llogarinë e veçantë i takon në mënyrë të përbashkët kreditorëve. Pjesa e secilit kreditor duhet të llogaritet proporcionalisht me shumën që është paguar në llogarinë e veçantë për interes të çdo kreditori.

9. Përmbaruesi gjyqësor privat plotëson menjëherë një deficit në bilancin e llogarisë së veçantë dhe është përgjegjës në lidhje me këtë deficit nëse nuk mund të provojë të kundërtën.

10. Një kreditor ka në çdo kohë të drejtën e pagesës së pjesës së tij në gjendjen e llogarisë së veçantë për aq sa i takon. Nëse gjendja e llogarisë së veçantë është e pamjaftueshme për të paguar pjesën e secilit kreditor, përmbaruesi gjyqësor mund t'i paguajë kreditorit një shumë që nuk cenon të drejtat e kreditorëve të tjerë. Në këtë rast, gjendja e llogarisë do të shpërndahet mes

kreditorëve proporcionalisht me pjesën e secilit. Në rast se përmbaresi gjyqësor privat është vetë posedues i ligjshëm i fondeve në llogari, ai do marrë proporcionalisht pjesën e tij, vetëm pasi të gjithë kreditorët e tjerë të ligjshëm kanë marrë pjesën për aq sa i takon.

11. Llogaria bankare e veçantë e përmbaruesit gjyqësor privat nuk mund të sekuestrohet dhe në lidhje me përdorimin e saj nuk paguhet komisione, interesa apo tarifa. Banka e Shqipërisë udhëzon të gjitha bankat lidhur me statusin e llogarisë bankare të veçantë të përmbaruesit gjyqësor privat.

12. Çdo veprim juridik i kryer në kundërshtim me dispozitat e këtij neni është i pavlefshëm.

Neni 43

Dorëzimi i dokumentacionit pas heqjes së licencës së përmbaruesit gjyqësor privat

1. Kur përmbaruesi gjyqësor privat i hiqet licenca dhe ka në proces ekzekutimi çështje përmbarimore të papërfunduara, Ministri cakton përmbaruesin gjyqësor privat zëvendësues, nga lista e vënë në dispozicion çdo vit, nga Dhoma, në përputhje me parashikimet e nenit 48 të këtij ligji.

2. Përmbaruesi gjyqësor privat, pas heqjes së licencës, dorëzon në Ministri, vulën personale, mjetin e identifikimit profesional, si dhe në rastin e çregjistrimit nga regjistri i përmbaruesve gjyqësorë privatë, arkivën e krijuar prej fillimit të veprimtarisë të tij.

3. Në rast moszbatimi vullnetar sipas parashikimeve të pikës 2 të këtij neni, Ministri lëshon urdhër për dorëzimin e vulës personale, mjetit të identifikimit profesional ose të arkivës, të përcaktuara në këtë nen, i cili përbën titull ekzekutiv.

4. Rregulla të hollësishme për procedurën dhe afatet e dorëzimit të dokumentacionit nga përmbaruesi gjyqësor privat dhe/ose zyrat e përmbarimit privat, arkivës dhe vulës personale përcaktohen me udhëzim të Ministrit.

Neni 44

Vula dhe dokumenti i identifikimit

1. Përmbaruesi gjyqësor privat ka vulën e vet personale dhe plumbin e sekuestrimit përmbarimor, që përmbajnë emrin e tij, të cilët vendosen në çdo dokument që ai krijon gjatë veprimtarisë së tij profesionale dhe/ose vendosen në sendet e luajtshme apo të paluajtshme të cilat i sekuestron, apo për të cilat kryen një veprim përmbarimor.

2. Përmbaruesi gjyqësor privat pajiset me dokument identifikimi si përmbarues gjyqësor privat, të cilin e paraqet në çdo rast të ushtrimit të detyrës.

3. Dokumenti përdoret vetëm gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të saj.

4. Dokumenti i identifikimit duhet të përmbajë:

- a) emrin, mbiemrin e përmbaruesit gjyqësor privat;
- b) stemën e Republikës së Shqipërisë dhe logon e Dhomës;
- c) selinë ku do të ushtrojë veprimtarinë përmbaruesi gjyqësor privat;
- ç) numrin e licencës së ushtrimit të veprimtarisë përmbarimore; dhe
- d) Numrin e Identifikimit të Subjektit (NUIS).

5. Forma dhe përmbajtja e vulës, forma e dokumentit të identifikimit dhe e plumbit të sekuestrimit përmbarimor, përcaktohen me urdhër të Ministrit, me propozim të Dhomës.

KREU VII

MARRËDHËNIET ME PALËT NË PROCES EKZEKUTIMI DHE ME TË TRETËT

Neni 45

Marrëdhëniet me palën kreditore

1. Marrëdhëniet ndërmjet përmbaruesit gjyqësor privat dhe palës kreditore rregullohen mbi bazën e kontratës së shërbimit të lidhur mes tyre, në të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve.

2. Pala kreditore ka të drejtë të kërkojë nga përmbaruesi gjyqësor privat çdo informacion, lidhur me veprimet procedurale dhe ecurinë e procesit të ekzekutimit.

Neni 46

Marrëdhënia kontraktore

1. Kur marrëdhëniet kontraktore ndërmjet përmbaruesit gjyqësor privat dhe palës kreditore zgjidhen nga përmbaruesi dhe/ose për shkak të tij, ai i kthen palës kreditore dokumentacionin ligjor të krijuar dhe mban pjesën e shumës së marrë si tarifë fikse për veprimet përmbarimore të kryera, deri në momentin e zgjidhjes së kontratës. Shuma e tarifës fikse të mbajtur parashikohet në kontratën e shërbimit të miratuar me urdhër të Ministrit sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Kur pala kreditore vendos të zgjidhë kontratën, pa shkaqe të arsyeshme, përpara përfundimit të procedurës së ekzekutimit, përmbaruesi gjyqësor privat i kthen dokumentacionin ligjor të vënies në ekzekutim palës kreditore, pas përmbushjes së detyrimit, për çdo shpenzim të vërtetuar me dokumente zyrtare deri në atë çast.

Neni 47

Vlefshmëria e akteve dhe veprimeve procedurale

Aktet dhe veprimet procedurale të kryera nga përmbauesi gjyqësor privat, përpara çastit të zgjidhjes së kontratës, konsiderohen ligjërish të vlefshme dhe procesi i mëtejshëm i ekzekutimit nga një përmbaues tjetër gjyqësor privat fillon nga veprimi procedural i mbetur në kohën e ndërprerjes së procesit të ekzekutimit.

Neni 48

Përmbauesi gjyqësor privat zëvendësues

1. Në rastin e heqjes së licencës dhe çregjistrimit nga regjistri i përmbauesve gjyqësor privat, ose në rast se përmbauesi gjyqësor privat nuk mund të përmbushë detyrat e tij për shkak të sëmundjes, mungesës ose pezullimit, Ministri mund të caktojë një përmbaues gjyqësor privat zëvendësues për një periudhë kohe të caktuar ose të pacaktuar, nga lista e vënë në dispozicion nga Dhoma sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Përmbaues gjyqësor privat zëvendësues mund të caktohet një përmbaues gjyqësor privat tjetër, që ka bërë kërkesë pranë Dhomës dhe është përfshirë në listën e miratuar sipas parashikimeve të këtij ligji.

3. Rregulla të hollësishme në lidhje me modalitetet, afatet dhe mënyrën e caktimit të përmbauesit gjyqësor privat zëvendësues, përcaktohen me udhëzim të Ministrit pas marrjes së mendimit të Dhomës.

Neni 49

Të drejtat dhe detyrat e përmbauesit gjyqësor privat zëvendësues

1. Përmbauesi gjyqësor privat zëvendësues ka të njëjtat të drejta dhe detyra si përmbauesi gjyqësor privat që zëvendëson.
2. Ministri urdhëron përmbauesin gjyqësor privat zëvendësues, për përmbushjen e veprimeve përmbaimore, që i drejtohen përmbauesit gjyqësor privat që zëvendësohet. Përmbauesi gjyqësor privat zëvendësues njofton subjektet përmbaimore për zëvendësimin.
3. Përmbauesi gjyqësor privat që zëvendësohet i lejon përmbauesit privat zëvendësues akses në dosjet e tij në masën që kërkohet për zëvendësimin.
4. Me përfundimin e zëvendësimit, përmbauesi gjyqësor privat zëvendësues i kthen përmbauesit gjyqësor të zëvendësuar prej tij dosjet dhe dokumentacionin e krijuar gjatë periudhës së zëvendësimit. Përmbauesi gjyqësor privat, i zëvendësuar njofton për këtë fakt

kreditorin dhe vazhdon kryerjen e veprimeve procedurale të mbetura në momentin e përfundimit të zëvendësimit.

5. Në kryerjen e veprimeve përmbarimore gjatë periudhës së zëvendësimit, përmbaruesi gjyqësor privat zëvendësues pasqyron emrin dhe mbiemrin e tij. Përmbaruesi gjyqësor privat zëvendësues përdor vulën e vet.

Neni 50

Heqja dorë nga procedura e ekzekutimit

1. Kur përmbaruesi gjyqësor privat vendos të heqë dorë nga vazhdimi i veprimeve procedurale, për shkak të konfliktit të interesit, ai detyrohet të njoftojë 15 ditë përpara palën kreditore. Gjatë kësaj periudhe përmbaruesi gjyqësor privat është i detyruar që të kryejë veprimet procedurale eventuale.
2. Pas kalimit të afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, përmbaruesi gjyqësor privat i kthen palës kreditore dokumentacionin e lidhur me çështjen, si dhe, kur është rasti, tarifën fikse për procedurën e ekzekutimit.

Neni 51

Marrëdhëniet me palën debitore dhe personin e tretë

1. Pala debitore, personat e barazuar me të ose personi i tretë detyrohet të lejojë përmbaruesin gjyqësor privat, të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për ekzekutimin e detyrueshëm, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile.

2. Debitori, me fillimin e veprimeve procedurale, pas kërkesës së përmbaruesit gjyqësor privat, deklaron pasuritë e tij dhe saktësinë e të dhënave të tyre. Ndaj debitorit, që fsheh, nuk jep apo i jep në mënyrë fiktive të dhënat mbi pasuritë e tij përmbaruesit gjyqësor privat, zbatohen sanksionet e parashikuara në këtë ligj dhe legjislacioni në fuqi.

3. Pala debitore, personat e barazuar me të ose personi i tretë ka të drejtë të kundërshtojë veprimet e përmbaruesit gjyqësor privat në gjykatë, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 52

Përgjegjësitë ndaj palëve në proces ekzekutimi dhe të tretëve

Përmbaruesi gjyqësor privat që kryen veprimtarinë e tij përmbarimore në kundërshtim me ligjin, mban përgjegjësi personale për dëmin që u shkakton palëve në proces ekzekutimi, si dhe për dëmin ndaj të tretëve.

Neni 53

Marrëdhëniet me të tretët

1. Përmbaruesi gjyqësor privat ka të drejtë të kërkojë informacionin e nevojshëm për procedurat e ekzekutimit, nga organet shtetërore, entet publike ose personat fizikë dhe juridikë, privatë apo shtetërorë, që zotërojnë një informacion të tillë, në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Informacioni i kërkuar i jepet përmbaruesit privat brenda pesë ditëve pune nga marrja e kërkesës me shkresë dhe jo më vonë se dy ditë pune kur informacioni kërkohet nëpërmjet komunikimit me postë elektronike, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

2. Ndaj personave fizikë ose juridikë që paraqesin pengesë gjatë procedurave të ekzekutimit ose fshehin, deklarojnë dhe/ose japin të dhëna të pasakta në lidhje me prona, të ardhura, të drejta mbi pasuritë e debitorit, të kërkuara nga përmbaruesi gjyqësor privat, kur këto veprime përbëjnë vepër penale në kuptim të nenit 320 të Kodit Penal, përmbaruesi gjyqësor privat bën kallzim penal.

3. Për ekzekutimin e titujve ekzekutivë, me objekt “Takim dhe kujdestari fëmijë”, përmbaruesi gjyqësor privat njofton njësinë për mbrojtjen e fëmijës pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki dhe kërkon asistencën e një psikologu.

4. Përmbaruesi gjyqësor privat ruan informacionin e marrë në përputhje me detyrimin e konfidencialitetit të parashikuar në nenin 41 të këtij ligji.

Neni 54

Kërkesa për ndihmën e Policisë së Shtetit

1. Përmbaruesi gjyqësor privat ka të drejtë që të kërkojë ndihmën e Policisë së Shtetit, të institucioneve të tjera shtetërore apo subjekteve private, në rastet, kur e çmon të arsyeshme, se veprimet procedurale përmbarimore nuk mund të kryhen pa mbështetjen, ndihmën dhe prezencën e tyre.

2. Kërkesa për ndihmë ose prezencë të organit policor, nga përmbaruesi gjyqësor privat, i drejtohet titullarit të Policisë së Shtetit në juridiksionin e vendit të ekzekutimit, 5 (pesë) ditë përpara se të kryhet procedura e ekzekutimit.

3. Në raste emergjence, kur është e nevojshme për të parandaluar rrezikun ndaj jetës, shëndetit ose pronës së përmbaruesit gjyqësor privat, ndihma dhe prania e punonjësve të Policisë së Shtetit mund të kërkohet edhe verbalisht. Në këto raste, përmbaruesi gjyqësor privat i paraqet Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Kryetarit të Dhomës një informacion me shkrim jo më vonë se dy ditë nga kalimi i gjendjes së emergjencës.

4. Rregullat të hollësishme lidhur kriteret, procedurën dhe mënyrën e bashkëpunimit dhe mbështetjes së përmbauesve gjyqësorë privat nga Policia e Shtetit përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe ministrit.

KREU VIII

TARIFAT

Neni 55

Tarifat fikse të veprimeve përmbaimore

1. Për fillimin e procedurave të ekzekutimit dhe kryerjen e veprimeve procedurale nga Shërbimi Përmbaimore Gjyqësor Privat, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile, paguhet tarifa fikse.
2. Masa e tarifës fikse caktohet duke mbajtur në konsideratë vlerën dhe llojin e detyrimit, si dhe kompleksitetin e veprimit procedural përmbaimore.
3. Masa e tarifës fikse të veprimit përmbaimore, llojet e veprimeve përmbaimore të tarifuara dhe rastet e përjashtimit nga parapagimi i tarifës për kategori të caktuara përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit dhe ministrit përgjegjës për financat, pasi merret dhe mendimi me shkrim i Dhomës.

Neni 56

Tarifa e suksesit

1. Përmbauesi gjyqësor privat përfiton një tarifë suksesi, e cila mund të jetë në formën e një shume të caktuar, një përqindjeje të caktuar mbi vlerën e detyrimit të vjelë ose titullit të ekzekutuar, ose nëpërmjet kombinimit të të dyjave mbi vlerën e detyrimit të ekzekutuar. Masa e tarifës së suksesit caktohet në marrëveshjen mes kreditorit dhe përmbauesit gjyqësor, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj.
2. Ministri dhe ministri përgjegjës për financat përcaktojnë me udhëzim të përbashkët nivelin minimal dhe maksimal të zbatimit të vlerës së tarifës së suksesit për veprimet përmbaimore. Tarifa e suksesit nuk parapaguhet dhe nuk i ngarkohet debitorit.

Neni 57

Rastet e pakthyeshmërisë së tarifës

1. Në rastet e ekzekutimeve të pasuksesshme, kur nga përmbauesi gjyqësor privat janë kryer në mënyrë të rregullt dhe të ligjshme të gjitha veprimet procedurale, tarifat fikse janë të pakthyeshme.

2. Kur pala kreditore ka paguar tarifën fikse të fillimit të procedurës përmbare dhe detyrimi përmbushet në mënyrë vullnetare nga pala debitore, brenda afateve ligjore, tarifa fikse e fillimit të procedurës është e pakthyeshme.

KREU IX

KONTROLI I VEPRIMTARISË SË PËRMBARUESVE

GJYQËSORË PRIVATË

Neni 58

Kontrolli veprimtarisë së përmbaruesve privatë nga Ministria

1. Veprimtaria e përmbaruesve gjyqësor privatë apo zyra të përmbarimit privat kontrollohet nga Ministria në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

2. Ministria ka të drejtë, kryesisht ose me kërkesën e palëve të interesuara, të kontrollojë veprimtarinë e përmbaruesve gjyqësorë privatë dhe të marrë masat e nevojshme për të eliminuar ose sanksionuar shkeljet e konstatuara.

3. Ministria ka detyrimin, që të paktën çdo katër vjet, të kontrollojë veprimtarinë e përmbaruesve gjyqësorë privatë.

4. Ministria ka të drejtë të:

a) Analizojë regjistrat e ekzekutimit, dosjen e çështjes në ekzekutim, dokumentet e ekzekutimit, të dhënat dhe materialet e tjera arkivore të përmbaruesit gjyqësor privat, faturat e tarifave përmbare dhe rimbursimet e shpenzimeve të paguara për përmbaruesin gjyqësor privat, veprimet në llogarinë e vecantë bankare dhe veprime të tjera financiare që lidhen me procedurat e ekzekutimit, për aq sa është e domosdoshme për të verifikuar përmbushjen e kushteve formale ligjore;

b) Kërkojë nga përmbaruesi gjyqësor privat të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me veprimtarinë e tij;

c) Kërkojë raporte për masat e marra nga përmbaruesi gjyqësor privat për ekzekutimin e çështjeve përmbare;

ç) Analizojë punën e zyra të përmbarimit privat, për të verifikuar zbatimin e standardeve profesionale të përmbaruesve gjyqësorë privatë;

d) Të kërkojë nga bankat, akses në të dhënat e llogarisë bankare të përmbaruesit gjyqësor privat, për efekt të kontrollit, të veprimeve të kryera nga kjo llogari, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

5. Ministria pas kryerjes së kontrollit, mund të urdhërojë marrjen e masave për korrigjimin e shkeljeve të kryera nga përmbauesit gjyqësor privat dhe mund të caktojë një afat për korrigjimin e këtyre shkeljeve ose kur është rasti mund të urdhërojë fillimin e procedimit disiplinor ndaj përmbauesit.

6. Rregulla të hollësishme për kontrollin e veprimtarisë së përmbauesve gjyqësorë privat përcaktohen me udhëzim të Ministrit.

7. Ministria, në përmbushje të funksioneve të kontrollit, mund të kërkojë mbështetjen e Dhomës për kryerjen e inspektimeve të përbashkëta.

8. Kontrolli i veprimtarisë së përmbauesve gjyqësorë privat, kryhet nga nëpunësit e strukturës përgjegjëse në Ministri. Në rastet e mungesës së burimeve njerëzore, si dhe mbulimit të fushave specifike, Ministria mund të angazhojë ekspertë të jashtëm të pavarur. Kriteret, procedurat e përzgjedhjes dhe shpërblimit të ekspertëve të jashtëm të pavarur, të cilët do të angazhohen në kryerjen e kontrollit, përcaktohen me udhëzim të Ministrit.

Neni 59

Mbikëqyrja e veprimtarisë së përmbauesve gjyqësorë privatë nga Dhoma

1. Pavarësisht kontrollit që kryhet nga Ministria sipas këtij ligji, Dhoma kryen mbikëqyrjen e veprimtarisë së përmbauesve gjyqësorë privatë, si dhe të ndihmës përmbauesve, në lidhje me respektimin e Kodit të Etikës, standardeve profesionale dhe përmbushjen e detyrimeve si anëtar i Dhomës. Dhoma kryen mbikëqyrje të rregullt të veprimtarisë të paktën një herë në dy vjet.

2. Dhoma përcakton që mbikëqyrja të kryhet nga një organ i veçantë i krijuar për këtë qëllim, i cili, raporton periodikisht pranë Dhomës dhe këshillon mbi veprimet që duhet të ndërmerren në përputhje me rezultatin e kontrollit.

3. Dhoma mund të vihet në lëvizje për kryerjen e mbikëqyrjes me nismën e saj, bazuar në një ankesë të një pale ose ankesë të një pjesëmarrësi në procedurën e ekzekutimit.

4. Dhoma nëse konstaton shkelje në veprimtarinë përmbaimore të një përmbauesi gjyqësor privat urdhëron përmbauesin të eliminojë të gjitha mangësitë në punën e tij, brenda afatit të përcaktuar prej saj dhe/ose të bëjë kërkesë për hetim të thelluar në përputhje me pikën 1 të nenit 62 të këtij ligji.

5. Dhoma dorëzon pranë Ministrisë raportin e mbikëqyrjes brenda 10 ditëve nga përfundimi i këtij procesi.

6. Rregulla të hollësishme për mbikëqyrjen e veprimtarisë dhe sjelljen profesionale të përmbauesve gjyqësor privat, si dhe ndihmës përmbauesve, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen nga Dhoma.

Neni 60

Raporti për veprimtarinë e përmbaruesve

1. Përmbaruesi gjyqësor privat ka detyrimin t'i paraqesë Ministrisë dhe Dhomës në formë elektronike një raport vjetor statistikor për veprimtarinë e tij. Raporti përfshin edhe informacion në lidhje me administrimin e llogarisë bankare të veçantë sipas parashikimeve të nenit 42 të këtij ligji.

2. Përmbaruesi gjyqësor privat ka detyrimin të paraqesë Ministrisë një raport me shkrim në lidhje me veprimtarinë përmbarimore të kryer gjatë një viti. Raporti vjetor dërgohet brenda tre mujorit të parë të vitit pasardhës.

3. Raporti përmban të dhënat e mëposhtme:

a) numrin e çështjeve përmbarimore të regjistruara në Regjistrin e çështjeve përmbarimore;

b) numrin e çështjeve të pushuara si të ekzekutuara tërësisht, të pezulluara dhe aktive;

4. Dhoma, për çdo vit kalendarik, dorëzon pranë Ministrit një raport vjetor statistikor përmbledhës për veprimtarinë e të gjithë përmbaruesve gjyqësorë privatë.

5. Forma, modalitetet dhe të dhënat që përmban raporti statistikor i veprimtarisë së përmbaruesit gjyqësor privat, përcaktohen me urdhër të Ministrit.

KREU X

PROCEDIMI DISIPLINOR

Neni 61

Fillimi i hetimit disiplinor

1. Ministri vendos të fillojë hetimin për shkeljen e pretenduar ose të arkivojë një ankesë, brenda tre muajve nga marrja e ankesës.

2. Ministri, brenda gjashtë muajve nga dita e marrjes së vendimit për fillimin e hetimit, fillon procedimin disiplinor duke i paraqitur Komisionit Disiplinor raportin e hetimit ose merr vendim për mbylljen e hetimit.

3. Ministri mund të zgjasë afatin e hetimit, të parashikuar në pikën 2, të këtij neni, në raste komplekse, për arsye të shtimit ose ndryshimit të objektit të hetimit, ose në rast sëmundjeje ose pamundësisë së përmbaruesit gjyqësor privat, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

4. Në rastet kur, pas kalimit të afateve të parashikuara në pikat 2 ose 3 të këtij neni, dalin prova të reja, mbi bazën e të cilave ka shkaqe të arsyeshme të besohet se shkelja mund të ketë ndodhur, Ministri riçel hetimin, me kushtin që të mos jenë parashkruar afatet, sipas përcaktimeve të nenit 85 të këtij ligji.

Neni 62

Ankesat

1. Çdo individ, person juridik, ose Dhoma ka të drejtë t'i paraqesë Ministrit ankesa të arsyetuara me shkrim.

2. Në rastet kur ka të dhëna të besueshme që përmbaruesi mund të ketë kryer shkelje disiplinore, çdo funksionar publik, që ka dijeni, duhet të informojë Ministrin.

3. Ministri ka detyrimin të shqyrtojë të gjitha ankesat, përveç atyre anonime. Ankuesi ka të drejtë të kërkojë ruajtjen e konfidencialitetit.

4. Ministri i konfirmon ankuesit marrjen e ankesës brenda 30 ditëve. Ministri i njofton ankuesit vendimin për arkivimin e ankesës, për fillimin e hetimit, shtimin ose ndryshimin e objektit të tij, si dhe mbylljen e hetimit, brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit përkatës.

5. Tërheqja e ankesës nga ankuesi nuk sjell arkivimin e ankesës dhe mbylljen e hetimit të filluar, nëse Ministri vlerëson që ka shkaqe të mjaftueshme për kryerjen e hetimit me iniciativën e tij.

6. Formulari i ankesës publikohet në faqen zyrtare të ministrisë.

Neni 63

Fillimi i hetimeve kryesisht

1. Ministri fillon hetimin me iniciativën e vet, bazuar në të dhëna thelbësore dhe mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer. Informacionet që përftohen nga media ose nga ankues anonimë mund të shërbejnë si indicie për të filluar një hetim kryesisht.

2. Ministri nxjerr urdhër të arsyetuar për fillimin e hetimit kryesisht, duke parashtruar rrethanat faktike të verifikueshme. Urdhri i njoftohet ankuesit dhe përmbaruesit.

Neni 64

Shtimi, ndryshimi i objektit të hetimit dhe bashkimi i hetimeve

1. Në rast se gjatë hetimit ngrihen dyshime të arsyeshme se një shkelje tjetër mund të ketë ndodhur, Ministri urdhëron shtimin ose ndryshimin e objektit të hetimit, në zbatim të nenit 63 të këtij ligji, dhe njofton ankuesin, Dhomen dhe përmbauesin.
2. Ministri bashkon hetimet, në rastet kur konstaton se ankesat ose hetimet e filluara u referohen të njëjtave fakte ose të njëjtit përmbaues.

Neni 65

Pezullimi i hetimeve

1. Ministri urdhëron pezullimin e hetimit disiplinor kur është duke u zhvilluar hetim penal ose një proces gjyqësor penal, administrativ ose civil:
 - a) në të cilat, njëra nga palët është përmbauesi gjyqësor privat;
 - b) shkelja e dyshuar lidhet me të njëjtat fakte, për të cilat do të merret vendimi.
2. Hetimi pezullohet deri në dhënien e vendimit të formës së prerë të institucionit kompetent.
3. Ankuesi, përmbauesi gjyqësor privat, gjykata, prokuroria, Dhoma dhe Komisioni Disiplinor njoftohen me shkrim për urdhrin e pezullimit. Gjykata, prokuroria ose institucione të tjera i dërgojnë Ministrit pa vonesë çdo vendim që merret gjatë hetimit dhe procesit përkatës.
4. Ministri u referohet vetëm fakteve mbi të cilat bazohet vendimi gjyqësor i formës së prerë. Vendimi gjyqësor i formës së prerë në favor të përmbauesit nuk pengon hetimin nga Ministri për të përcaktuar përgjegjësinë disiplinore të përmbauesit.
5. Pezullimi i hetimeve ndërpret afatet e parashkrimit, të parashikuara nga neni 85 i këtij ligji.
6. Urdhri për pezullimin e hetimit nuk ankimohet.

Neni 66

Të drejtat e përmbauesit gjatë hetimit

1. Përmbauesi është palë në proces që nga momenti i fillimit të hetimit, sipas neneve 61 ose 63 të këtij ligji, dhe i garantohet aksesin në dosjen e hetimit në atë masë që nuk cënon sekretin e hetimit.
2. Ministri mund të kërkojë nga përmbauesi informacione, dokumente ose çdo provë që është e nevojshme për hetimin.
3. Ministri i njofton përmbauesit, ose përfaqësuesit të tij, si dhe Dhomës, vendimin për arkivimin e ankesës, për fillimin e hetimit, shtimin ose ndryshimin e objektit të tij, si dhe mbylljen e hetimit.

Neni 67

Ecuria e hetimeve

1. Objekti i hetimit tregon qartë elementet e shkeljes së pretenduar, sipas përcaktimeve në urdhrin për fillimin e hetimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Ministri thërret dëshmitarë dhe mbledh të dhëna, dokumente dhe prova nga gjykata, prokuroria, institucione të tjera shtetërore, organizata, dëshmitarë dhe/ose përmbaruesit, dhe ndërmerr veprime të nevojshme për të hetuar dhe përcaktuar nëse shkelja e pretenduar ka ndodhur.

Neni 68

Kërkesat për marrjen në pyetje

1. Kur Ministri vlerëson se marrja në pyetje e përmbaruesit, dëshmitarëve ose personave të tjerë paraqet rëndësi për hetimin, i njofton ata lidhur me kohën dhe vendin e seancës së marrjes në pyetje.

2. Ministri merr masa për dokumentimin e seancës së marrjes në pyetje sipas rregullave të parashikuara në këtë nen.

3. Regjistrimi audio i seancës së marrjes në pyetje përmbledhet në procesverbal dhe zbardhet, me kërkesë të palëve. Përmbaruesi nënshkruan procesverbalin e marrjes në pyetje, si dhe transkriptimin e regjistrimit audio.

4. Regjistrimi audio, transkriptimi i tij, si dhe procesverbali i seancës së marrjes në pyetje bëhen pjesë e dosjes.

Neni 69

Kërkesat në lidhje me mbledhjen e provave nga institucionet e tjera

1. Çdo organ publik, person fizik ose juridik përmbush në kohë kërkesat e Ministrit për marrje informacioni, dokumente ose prova të tjera që lidhen me hetimin, brenda afateve kohore të arsyeshme, të përcaktuara nga Ministri në kërkesën e tij, me përjashtim të rasteve kur dhënia e tyre është e kufizuar me ligj.

2. Ministri përsërit kërkesën në rastin kur personi ose subjekti, të cilit i drejtohet kjo kërkesë, nuk e përmbush atë brenda afatit të caktuar, duke informuar në rastin e personit juridik edhe drejtuesin e tij. Në rastin kur personi ose subjekti, të cilit i drejtohet kjo kërkesë, nuk përmbush kërkesën e përsëritur brenda afatit të caktuar, Ministri njofton organin përgjegjës disiplinor.

3. Nëse gjatë hetimit disiplinor të përmbaruesit ekzistojnë nevoja thelbësore dhe specifike për të marrë dokumente, informacione, të cilat mbrohen nga legjislacioni për mbrojtjen e të

dhënave personale, Ministri mund t'i kërkojë gjykatës me juridiksion të përgjithshëm së shkallës së parë, lëshimin e një urdhri për dhënien e informacionit të kërkuar për përmbauesin. Vendimi i gjykatës merret nga gjyqtari i vetëm në dhomë këshillimi, brenda 15 ditëve nga dorëzimi i kërkesës.

4. Kërkesa duhet të përmbajë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm se përmbauesi ka kryer shkeljen, si dhe se informacioni i kërkuar është thelbësor për të përcaktuar nëse shkelja ka ndodhur.

Neni 70

Dokumentacioni i hetimit

1. Struktura përgjegjëse në ministri dokumenton çdo veprim hetimor me procesverbal.

2. Procesverbali duhet të përmbajë:

a) emrin dhe mbiemrin e personit përgjegjës që kryen veprimin;

b) datën e kryerjes së veprimit;

c) subjektin dhe objektin e veprimit;

ç) pjesëmarrësit;

d) përshkrimin e hollësishëm të veprimit të kryer;

dh) nënshkrimin e inspektorit e të personave që marrin pjesë në këto veprime;

3. Me përfundimin e hetimit, struktura përgjegjëse në Ministri harton raportin e hetimit, i cili përmban të paktën:

a) emrin dhe mbiemrin e hartuesve të raportit;

b) shkaqet për të filluar hetimin, subjektin dhe objektin e hetimit, sipas përcaktimeve të bëra në vendimin për fillimin e hetimit, ndryshimin ose shtimin e objektit të hetimit;

c) veprimet e kryera gjatë hetimit;

ç) përmbledhjen e deklaratave të përmbauesit përkatës dhe të personave të tjerë ose institucioneve;

d) parashtrimin e fakteve të pranuar dhe të papranuar, ashtu si edhe të provave, si dhe vlerësimin e vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre;

dh) analizën ligjore të fakteve të pranuar që mbështesin përfundimin se shkelja disiplinore e pretenduar është kryer ose se hetimi duhet mbyllur;

e) propozimin për mbylljen e hetimit ose për fillimin e procedimit disiplinor dhe propozimin për caktimin e masës disiplinore.

Neni 71

Përfundimi i hetimit

1. Në përfundim të hetimit, nëse ka dyshime të arsyeshme që përmbaruesi ka kryer shkelje disiplinore, Ministri fillon procedimin disiplinor, duke paraqitur në Komisionin Disiplinor raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore.

2. Ministri mbyll hetimin, nëse provohet se pretendimet janë të pabazuara ose provat e mbledhura dhe rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit se:

- a) provat janë të pamjaftueshme për të provuar kryerjen e shkeljes disiplinore;
- b) çështja ka qenë objekt i një hetimi të mëparshëm që është mbyllur ose për të cilën është dhënë vendim i formës së prerë në kuadër të një procedimi disiplinor, përveç rasteve kur paraqiten fakte ose prova të reja;
- c) çështja është parashkruar në kohën kur është filluar hetimi, për shkak të kalimit të afateve;
- ç) përmbaruesi ka ndërruar jetë.

3. Ministri i njofton vendimin përmbaruesit të interesuar ose përfaqësuesit të tij, ankuesit dhe Dhomës. Vendimi përmban arsyet për mbylljen e hetimit, sipas pikës 2 të këtij neni.

Neni 72

Ridërgimi i çështjes Ministrit

Nëse gjatë procedimit disiplinor, Ministri merr informacion se ka dyshime të arsyeshme që mund të jetë kryer një shkelje tjetër, atëherë:

- a) i kërkon Komisionit Disiplinor të ndërpresë procedimin disiplinor, urdhëron shtimin ose ndryshimin e objektit të hetimit, kryen hetimin e nevojshëm dhe paraqet raportin e hetimit të mëtejshëm brenda 1 muaji nga ndërprerja e procedimit; ose
- b) i kërkon Komisionit Disiplinor që të shtojë ose ndryshojë objektin e procedimit disiplinor, nëse nuk është e nevojshme kryerja e hetimeve të mëtejshme.

Neni 73

Komisioni Disiplinor

1. Komisioni Disiplinor përbëhet nga tre anëtarë me integritet dhe reputacion të lartë profesional, nga të cilët:

- a) 1 anëtar zgjidhet nga Shkolla e Magjistraturës;
- b) 1 anëtar zgjidhet nga Ministri i Drejtësisë;

c) 1 anëtarë zgjidhet nga Dhoma nga rradhët e përmbauesve gjyqësorë privatë.

2. Kandidatët e zgjedhur sipas pikës 1, shkronjat “a” dhe “b”, të këtij neni duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) të jenë shtetas shqiptarë;

b) të kenë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi, ose diplomë të njësuar me të;

c) të kenë jo më pak se 10 vjet përvojë profesionale si jurist;

ç) të mos jenë shkarkuar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe të mos kenë masë disiplinore në fuqi;

d) të mos kenë qenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

dh) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit në kuptimin e legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë;

e) në kohën e kandidimit, të mos kenë asnjë anëtar të familjes, si dhe të afërm të shkallës së parë që është përmbaues gjyqësor në detyrë.

3. Në përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Disiplinor kanë përparësi, kandidatët që zotërojnë titull ose gradë shkencore ose kanë eksperiencë të provuar shkencore dhe/ose profesionale në çështjet e së drejtës civile.

4. Rregulla të hollësishme mbi paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjorë, përcaktohen me urdhër të Ministrit, me propozim të Dhomës.

5. Anëtarët e komisionit disiplinor emërohen për një mandat katër vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme.

6. Anëtarët e Komisionit Disiplinor zgjedhin në mbledhjen e parë Kryetarin e Komisionit Disiplinor, me një mandat dy vjeçar, me shumicën e të gjithë anëtarëve të Komisionit.

7. Zgjedhja e anëtarit të Komisionit Disiplinor sipas pikës 1 shkronja “c” të këtij neni, duhet të synojë shmangien konfliktin e interesit.

8. Anëtarët e Komisionit Disiplinor duhet të jenë të pavarur e të paanshëm në vendimmarrjen e tyre.

9. Anëtarët e Komisionit Disiplinor duhet të tërhiqen nga shqyrtimi i çështjeve, kur ata kanë konflikt interesi, apo ka dyshime në lidhje me paanësinë e tyre në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative.

10. Komisioni Disiplinor zbaton për aq sa është e mundur, rregullat e Kodit të Procedurës Administrative, kur ky ligj nuk parashikon rregulla të veçanta.

11. Mbledhja e Komisionit Disiplinor është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Vendimet e Komisionit Disiplinor miratohen me shumicën e të gjithë anëtarëve të Komisionit. Përveç se kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, zbatohen për aq sa

gjejnë zbatim dispozitat e ligjit për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike.

12. Komisioni Disiplinor është një organ *ad hoc* dhe mbështetet administrativisht nga Dhoma.

13. Rregulla të hollësishme për konstituimin, organizimin, funksionimin dhe shpërblimin e anëtarëve të Komisionit Disiplinor përcaktohen nga Ministri, me propozim të Dhomës.

Neni 74

Procedura përpara Komisionit Disiplinor

1. Komisioni Disiplinor:

a) përcakton një datë për seancën dëgjimore, e cila duhet të jetë jo më vonë se 15 ditë nga data e marrjes së dosjes nga Ministri; dhe

b) njofton palët për zhvillimin e seancës së paku 10 ditë përpara.

2. Afati i parashikuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni, mund të zgjatet deri në 45 ditë, nëse Komisioni Disiplinor është i bindur se ka arsye të rëndësishme për shtyrjen.

3. Komisioni Disiplinor duhet të marrë parasysh të gjitha rrethanat që kanë lidhje me çështjen.

4. Komisioni Disiplinor mund:

a) të marrë dëshmi shtesë, duke përfshirë thirrjen e dëshmitarëve; dhe

b) të angazhojë ekspertë, kur e konsideron të përshtatshme.

5. Nëse provat shtesë nuk mund të sigurohen, Komisioni Disiplinor mund të kërkojë nga Ministri që të kryejë hetime të mëtejshme duke specifikuar elementët e munguar dhe periudhën kohore për të cilën kërkohet hetimi.

Neni 75

Mbyllja e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore

1. Komisioni Disiplinor vendos mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore nëse:

a) shkelja disiplinore është parashkruar në kohën kur ka filluar hetimi, sipas parashikimeve të nenit 85 të këtij ligji;

b) pas nisjes së procedimit rezulton se çështja ka qenë objekt i një procedimi të mëparshëm;

c) ka arsye të tjera për të mbyllur procedimin, në përputhje me parashikimet e nenit 71, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji.

2. Heqja dorë nga ushtrimi i profesionit nga përmbarduesi nuk ndalon fillimin ose vazhdimin e procedimit disiplinor.

3. Komisioni Disiplinor mbyll procedimin disiplinor, sipas parashikimeve të pikës 1, të këtij neni, me vendim të arsyetuar me shkrim. Komisioni Disiplinor njofton palët për shkaqet e mbylljes së procedimit.

Neni 76

Ndryshimi, shtimi i objektit të procedimit disiplinor dhe bashkimi i procedimeve disiplinore

1. Komisioni Disiplinor, kur konstaton që procedimi disiplinor u referohet të njëjtave fakte dhe të njëjtit përmbardues, mund të vendosë bashkimin e procedimeve.
2. Komisioni Disiplinor, kur e çmon se çështja nuk mund të zgjidhet në mënyrë të drejtë dhe të rregullt pa marrë në shqyrtim një ose disa pretendime të tjera për shkeljen disiplinore ndaj të njëjtit përmbardues, ka të drejtë:
 - a) të vendosë mbi pretendimet e ndryshuara ose të shtuara, nëse nuk është i nevojshëm hetimi i mëtejshëm, pasi të ketë dëgjuar palët në procedim; ose
 - b) pa pezulluar procedimin disiplinor, t'i kërkojë Ministrit të ndryshojë ose të shtojë objektin e procedimit disiplinor, në përputhje me këtë ligj, si dhe të hetojë këto pretendime të tjera të paktën brenda afatit njëmuajor.

Neni 77

Të drejtat dhe detyrimet e palëve gjatë procedimit disiplinor

1. Gjatë procedimit disiplinor, përmbarduesit ose përfaqësuesit të tij, i sigurohet akses në dosje në masën që nuk cenon:
 - a) interesat ligjorë të palëve ose personave të tretë;
 - b) funksionet e organit vendimmarrës;
 - c) qëllimin e procedimit.
2. Kur përmbarduesit i njoftohet se ndaj tij ka filluar procedim disiplinor, duhet që t'i bëhen të ditura të drejtat:
 - a) për të paraqitur një parashitje me shkrim në afatin e caktuar;
 - b) për të marrë pjesë në seancë dëgjimore;
 - c) për të thirrur dëshmitarë që mund të dëshmojnë fakte me interes për çështjen;

- ç) për të paraqitur dokumente;
 - d) për të marrë masa të tjera për paraqitjen e provave në mbështetje të mbrojtjes së tij;
 - dh) për t'u përfaqësuar, sipas parashikimeve në Kodin e Procedurave Administrative.
3. Komisioni Disiplinor mund t'i kërkojë përmbaruesit të paraqesë të dhëna, dokumente ose çdo lloj prove, si dhe të marrë pjesë në seancë dëgjimore.
4. Palët kanë të drejtë të njoftohen për çdo vendim të Komisionit Disiplinor brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

Neni 78

Seanca dëgjimore

1. Seanca dëgjimore për procedimet disiplinore është publike.
2. Komisioni Disiplinor, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë zhvillimin e seancës me dyer të mbyllura, në rastet kur:
 - a) publiciteti i seancës mund të dëmtojë moralin e shoqërisë ose mund të bëjë publike të dhëna sekrete që cenojnë sigurinë kombëtare, nëse kjo kërkohet nga autoritetet kompetente;
 - b) është e nevojshme të mbrohet e drejta e jetës private, sekreti tregtar, ose të dhënat personale të përmbaruesit ose një personi tjetër;
 - c) kur nga publiku kryhen veprime që prishin zhvillimin normal të seancës dëgjimore.
3. Komisioni Disiplinor mund të shtyjë seancën për një periudhë jo më shumë se një muaj, kur konsideron të nevojshme marrjen e provave shtesë.

Neni 79

Pezullimi i procedimit disiplinor

Rregullat për pezullimin e hetimit disiplinor, sipas nenit 65 të këtij ligji, zbatohen për aq sa është e mundur për pezullimin e procedimit disiplinor.

Neni 80

Vendimet e Komisionit Disiplinor për çështjet e disiplinës

1. Komisioni Disiplinor merr vendim në lidhje me:
 - a) angazhimin e ekspertëve dhe përcaktimin e detyrave të tyre;
 - b) shtyrjen e seancave;

- c) pranueshmërinë e provave;
 - ç) zgjidhjen e çështjes; dhe
 - d) çdo çështje tjetër që Komisioni Disiplinor e vlerëson të nevojshme ose të përshtatshme në trajtimin e çështjes.
2. Pas shqyrtimit të të gjitha fakteve dhe provave, Komisioni Disiplinor vendos:
- a) rrëzimin e kërkesës për procedim disiplinor, për shkak se faktet e pretenduara nuk kanë ndodhur ose ato nuk përbëjnë shkelje disiplinore; ose
 - b) pranimin e kërkesës, marrjen e një ose më shumë masave disiplinore dhe njoftimin e vendimit Ministrit.
3. Komisioni Disiplinor shqyrton masën disiplinore të propozuar nga Ministri dhe jep vendim të arsyetuar me shkrim brenda dy javëve nga përfundimi i seancës.

Neni 81

Ekzekutimi i vendimeve

1. Ministria merr të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e masave disiplinore dhe është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të të gjitha masave që vendosen në procedimin disiplinor.
2. Ministria siguron zbatimin e masave disiplinore:
- a) brenda një muaji, në rastin e gjobës;
 - b) brenda dy javëve në të gjitha rastet tjera, sipas vendimmarrjes së Komisionit Disiplinor.
3. Në rastin e masës disiplinore me gjobë, përmbaruesi gjyqësor privat shlyen masën e gjobës sipas afatit të përcaktuar në pikën 2 shkronja “a” të këtij neni, në të kundërt, ndaj tij zbatohet masa disiplinore e pezullimit të licencës deri në çastin e shlyerjes së saj.

Neni 82

Publikimi i vendimeve disiplinore

1. Ministria dhe Dhoma publikojnë brenda 2 javëve, bazuar mbi informacionin e marrë nga Komisioni Disiplinor, çdo vendim të formës së prerë, në faqet e tyre zyrtare.
2. Botimi i vendimeve të Komisionit Disiplinor duhet të mbrojë të dhënat personale dhe të garantojë mbrojtjen e konfidencialitetit. Në çdo rast, nuk botohet asnjë informacion që mund të tregojë identitetin e përmbaruesit gjyqësor privat.

Neni 83

Regjistri disiplinor

1. Ministria dhe Dhoma mbajnë një regjistër për çështjet disiplinore të filluara ndaj përmbauesve, si dhe vendimet e formës së prerë për këto procedime.

2. Komisioni Disiplinor mban të dhëna për të gjitha masat disiplinore në fuqi. Këto masa disiplinore shuhen dhe fshihen nga regjistri pas kalimit të afateve të mëposhtme nga data e hyrjes në fuqi të masës disiplinore:

a) ka kaluar një vit nga pagesa e gjobës;

b) kanë kaluar tre vjet që nga vendosja e masës disiplinore të pezullimit nga detyra.

3. Masa disiplinore e heqjes të licencës së ushtrimit të veprimtarisë përmbaimore nuk fshihet nga regjistri.

KREU XI

SHKELJET DHE MASAT DISIPLINORE

Neni 84

Shkeljet disiplinore

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë shkelje disiplinore. Konsiderohen shkelje nga përmbauesi gjyqësor privat veprimet ose mosveprimet e mëposhtme:

a) shkelja në mënyrë të përsëritur e rregullave të parashikuara nga ky ligj dhe aktet nënligjore, që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë së përmbauesit gjyqësor privat dhe/ose shkelja në mënyrë të përsëritur e detyrave të parashikuara në nenin 37 të këtij ligji;

b) mospërbushja me faj e veprimeve përmbaimore, që kanë cenuar të drejtën e palëve në proces ekzekutimi;

c) mosrespektimi i dispozitave të kodit të etikës dhe standardeve profesionale së përmbauesit gjyqësor privat;

ç) shkelja e besimit të palës kontraktuese, nëpërmjet kryerjes së veprimeve korruptive me palën tjetër, për të mos ekzekutuar apo vonuar ekzekutimin e titullit ekzekutiv;

d) konflikti i interesit në një procedurë ekzekutive;

dh) mosevidentimi në mënyrë të rregullt i të gjitha akteve dhe veprimeve procedurale të kryera gjatë veprimtarisë së ekzekutimit;

e) shkelja e kërkesave të këtij ligji për konfidencialitetin, sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave që merr, si rezultat i ushtrimit të veprimtarisë së vet gjatë procedurës së ekzekutimit;

- ë) refuzimi për të mos lejuar strukturat përgjegjëse shtetërore për të ushtruar kontroll ndaj veprimtarisë procedurale të tij dhe refuzimi i pagimit të detyrimit profesional;
- f) ushtrimi i praktikave të ndaluara sipas nenit 38 të këtij ligji;
- g) moslidhja e marrëveshjes së sigurimit të përgjegjësisë profesionale;
- gj) fshehja me dashje e pengesave ligjore për licencim sipas nenit 16 të ligjit;
- h) zbatimi i tarifave ose rimbursimeve më të larta ose më të ulta se niveli i parashikuar me udhëzimin e miratuar për këtë qëllim, ose afrimi i kreditorëve duke zbatuar tarifa më të ulta në krahasim me nivelin e tarifave të parashikuar në udhëzimin e miratuar për këtë qëllim;
- i) pakujdesi në drejtim të administrimit të zyrës, si pasaktësi në mbajtjen e regjistrave dhe të dokumentacionit;
- j) tejkalimi i kompetencave të dhëna nga ligji;
- k) trajtimi i pasurive dhe aseteve në kundërshtim me ligjin ose autorizimin e palëve;
- l) bërja publike e rrethanave personale, familjare dhe financiare të mësuara gjatë kryerjes së veprimtarisë së përmbauesit gjyqësor privat;
- ll) refuzimi për t'u angazhuar në trajnimin profesional vazhdues pa arsye të përligjura;
- m) shkelja e detyrave sipas akteve nënligjore në fuqi;
- n) punësimi në detyrë publike, administrative ose mbikëqyrëse ose angazhim në një shoqëri tregtare ose institucion publik ose në veprimtari si noter, avokat, veprimtari tregtare ose ndërmjetësuese ose ushtrimi i profesionit në kundërshtim me reputacionin, integritetin ose paanësinë e përmbauesit gjyqësor privat në kundërshtim me nenin 12 dhe 13 të këtij ligji;
- nj) kryerja e transaksioneve të veta në emër të një personi tjetër ose të transaksioneve të një personi tjetër në emër të vet, qenia palë në transaksione për të cilat vepron edhe si përmbaues gjyqësor privat dhe/ose përvetësimi i aseteve të lëna në ruajtje si pjesë e veprimtarisë së tij si përmbaues gjyqësor privat;
- o) shkelja e rregullave për krijimin, administrimin dhe ruajtjen e arkivit.

2. Nëse përmbauesi gjyqësor privat kryen më shumë se një herë dhe/ose njëkohësisht dy nga shkeljet e parashikuara në shkronjat “d”, “dh”, “e”, “ë”, “g”, “i”, “k”, “l”, “ll”, “m”, “nj”, “o” të këtij neni, ai konsiderohet se ka kryer shkeljen e parashikuara në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni.

Neni 85

Masat disiplinore

1. Masat disiplinore jepen bazuar në natyrën dhe rëndësinë e shkeljes. Për kryerjen e shkeljeve të parashikuara në nenin 84 të këtij ligji, jepen masat disiplinore si më poshtë:

- a) për shkeljen e përcaktuar në shkronjat “a”, “b”, “ç”, “f”, “gj” dhe “n” heqje të licencës dhe çregjistrimin nga regjistri;
 - b) për shkeljen e përcaktuar në shkronjat “c”, “d”, “dh”, “h”, “i”, “ll”, “m”, dhe “o” me gjobë nga 50 000 deri 200 000 lekë;
 - c) për shkeljen e përcaktuar në shkronjat “e”, “ë”, “g”, “j”, “k”, “l”, “nj” me pezullim të licencës nga tre muaj deri në dy vjet.
2. Masat disiplinore jepen brenda 6 muajve nga data e konstatimit të shkeljes, por jo më vonë se 2 vjet nga çasti i kryerjes së saj. Në këtë rast parashkrimi i masës fillon pas afateve të përcaktuara.
 3. Masat disiplinore të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, mund të jepen vetëm me vendim të Komisionit Disiplinor.

Neni 86

E drejta e ankimit

1. Kundër vendimeve të Komisionit Disiplinor mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative kompetente brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
2. Vendimi i Komisionit Disiplinor, pas kalimit të afatit të ankimit, ose kur lihet në fuqi nga gjykata, evidentohet në regjistrin e përmbaruesve gjyqësorë privatë.
3. Në rastin e vendimit për heqje të licencës dhe çregjistrimin nga regjistri, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 85 të këtij ligji, Ministri merr masat e nevojshme për njoftimin e vendimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me qëllim çregjistrimin nga regjistri tregtar.

Neni 87

Arkëtimi i gjobave në Buxhetin e Shtetit

Gjoba e vendosur kundër subjekteve që pengojnë ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë arkëtohet në Buxhetin e Shtetit.

KREU XII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 88

Dispozita kalimtare

1. Certifikatat e aftësisë profesionale të lëshuara nga Ministri i Drejtësisë dhe licencat për përmbaues gjyqësor privat, të lëshuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, mbeten të vlefshme për sa kohë sa nuk bien ndesh me parashikimet e këtij ligji.

2. Parashikimet e bëra në pikat 1 dhe 4 të nenit 9 të këtij ligji, nuk sjellin pasoja për certifikatat e aftësisë profesionale të përmbauesve gjyqësorë privatë dhe nuk cenojnë selinë ekzistuese të veprimtarisë së përmbauesve gjyqësorë privatë ose të zyrave të përmbaimit privat, deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Procedurat disiplinore të nisura ose në proces, në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përfundojnë sipas dispozitave të zbatueshme përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

4. Organet drejtuese të Dhomës të zgjedhura në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008, "Për shërbimin përmbaimit gjyqësor privat", të ndryshuar, qëndrojnë në detyrë deri në përfundim të mandatit.

5. Dhoma merr masat e nevojshme për ngritjen dhe fillimin e funksionimit të Qendrës Kombëtare të Trajnimit të Përmbauesve, jo më vonë se 1 vit nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

6. Ministria, në bashkëpunim me Dhomën, brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, merr masa për evidentimin dhe marrjen në dorëzim të arkivave të padorëzuara ende ndër vite. Modalitetet e evidentimit dhe hapat që duhen ndjekur për marrjen në dorëzim të arkivave, sipas këtij ligji, përcaktohen me urdhër të Ministrisë.

7. Çdo përmbaues gjyqësor privat dorëzon dosjen e plotë personale të rifreskuar pranë Ministrisë brenda 1 muaji nga miratimi i listës së dokumenteve dhe formatit të vetëdeklarimit nga Ministri. Lista e dokumenteve që dorëzohen dhe formati i vetëdeklarimit të të dhënave të kërkuara përcaktohet me urdhër të Ministrisë, pas konsultimit me Dhomën, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

8. Ngarkohen përmbauesit gjyqësorë privatë të ndryshojnë emërtimin e shoqërive përmbaimore private në "zyrë e përmbaimit privat" dhe të plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 6 të këtij ligji, brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Mospërmbyshja e këtij detyrimi përbën shkelje disiplinore dhe passjell fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbauesit gjyqësor privat.

Neni 89

Aktet Nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave, që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore sipas nenit 24 pika 2 dhe nenit 39 të këtij ligji.

2. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë, që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të parashikimeve të këtij ligji, përveç kur nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj.

3. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë dhe ministri përgjegjës për financat që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të nenit 55 pika 3 dhe 56 pika 2 të këtij ligji.

4. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë dhe ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrin aktin nënligjor në zbatim të nenit 54 pika 4 të këtij ligji.

5. Ngarkohet Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të marrë masat për ndryshimin e statutit të saj si dhe miratimin e akteve nënligjore në kompetencë të saj, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

Neni 90

Shfuqizime

1. Ligji nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbauesor gjyqësor privat”, i ndryshuar shfuqizohet.
2. Aktet nënligjore të miratura në zbatim të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbauesor gjyqësor privat”, i ndryshuar mbeten në fuqi deri në miratimin e akteve të reja nënligjore për sa nuk bien në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji.

Neni 91

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI